


Zoran Zaev
Emri pa
përkthim, i
papranueshëm

Fq.4



**RRUGËT ME
VËSHTIRËSI**
Malësia e
Tetovës telashe
me borën

Fq.8



**Dua të qëndroj
në Milano,
sepse
ndihem si
në shtëpi**

Fq.21



Koha

www.koha.mk



**Për dy vite,
23 aborte**

Fq.8

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3303 · e martë 27 shkurt, 2018

-4°C | 1°C

15 DEN

EDITORIAL

**Politika
dhe arti**



Gjithë ky shkëlqim i artistëve shqiptarë nëpër festivale botërore flet për papërputhshmërinë e dy realiteteve në shoqërinë shqiptare: realiteti politik dhe ai kulturor. Arti e gjen rrugën e vet të afirmimit, ndërkohë që politika jointentive bën çmos që ta izolojë shoqërinë shqiptare nga tregu u gjerë i vlerave të përbotsme. Shembull më tipik është kjo që po ndodhë në...

Fq.2

SPECIALE

**Bunkeri
sekret i Titos
në Bosnjë
që kushtoi
4.6 miliardë
dollarë**

Fq.15

GLOBI

**Nëse nuk
vdesim nga
sulmet,
do vdesim
nga uria**

Fq.17



ÇËSHTJE DITËSH KUR LIGJI PËR GJUHËT TË VOTOHET NË PARLAMENT

AMENDAMENTET NË KONTEJNER



Debati rreth Ligjit për gjuhët ka përfunduar dhe se Ligji, sipas deputetit Artan Grubi, do të votohet këto ditë, që jep të kuptojë se Parlamenti nuk do diskutojë fare në lexim të tretë rreth amendamenteve të VMRO-së

Fq.3

Shqiptarët e diskriminuar të paraqiten në MPB

Shkup, 26 shkurt - Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim i mungojnë kriteret e qarta dhe mirë të definuara që kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të sigurisë dhe me shkallën e sigurisë. Ky është vlerësim i zëvendësministrit për Punë të Brendshme, Agim Nuhiu, i cili duke u përgjigjur në pyetjet për diskriminimin që ju bëhet nëpunësve shqiptarë, me mosdhënien e certifikatave të sigurisë, tha se këto probleme

kanë ekzistuar në vazhdimësi dhe të njëjtat janë në zgjidhje e sipër. Duke e komentuar rastin e fundit, me mos vazhdimin e certifikatave për sigurisë, të Enver Kurtshit dhe dy kolegëve të tij, të punësuar në Aeroportin e Shkupit, Nuhiu thotë se nuk e i përjashton paragjykimet dhe arbitraritetin nga punonjës dhe inspektor të caktuar të DSK-së. Puna të cilën e bëjnë këta inspektorë, sipas Nuhiut...

Fq.5



EDITORIAL

POLITIKA DHE ARTI



Emin AZEMI

Tani kur jetojmë në kohën e semiotikës moderne në komunikim dhe në bashkëveprim me një ambient më të gjerë sociale kulturor, politika duhet pa kursyer të shfrytëzojë mimetikën artistike. Por, për ta bërë këtë nevojitet edhe pak guxim qytetar i njerëzve të politikës që nënkupton përfshirjen e atyre resurseve krijuese që mund të mbindërtojnë një realitet më fisnik në përditshmërinë tonë

Gjithë ky shkëlqim i artistëve shqiptarë nëpër festivale botërore flet për papërputhshmërinë e dy realiteteve në shoqërinë shqiptare: realiteti politik dhe ai kulturor. Arti e gjen rrugën e vet të afirmimit, ndërkohë që politika joinventive bën çmos që ta izolojë shoqërinë shqiptare nga tregu u gjerë i vlerave të përbotshme. Shembull më tipik është kjo që po ndodhë në Kosovë. Sportistët dhe artistët e këtij vendi po e kryejnë për mrekulli rolin e ambasadorit në botë dhe, lirisht mund të thuhet se po të mos ishin ata, Kosova që moti do të harrohej edhe nga miqtë më entuziast të saj. Xhudistja Majlinda Kelmendi dhe një sërë artistësh të filmit, muzikës, artit figurativ janë kthyer në vendlindje më mirënjohjet më të larta, përfshi edhe medaljet e arta.

Pra kjo zberthen fenomenin e strukturës së talentëve dhe potencialit krijues brenda një shoqërie, pavarësisht se cilat janë agjendat politike dhe niveli i kreativitetit të atyre që i përpilojnë ato agjenda.

Si të puçet kreativiteti artistik me atë politik? Askush deri më tani nuk ka provuar që politikës t'i jepet paksa sharm arti, por përkundrazi ka ndodhura më e çuditshmja, arti është dëbuar nga politika si ndonjë lugat. Këtë parasegjithash e kanë bërë inferiorët e politikës, të cilët prej se kishin lexuar lekturat "Lugjet e verdha" dhe "Posta e porositur" kur kanë qenë voccrakë, nuk kishin bërë as edhe një hap më tej në ngritjen e tyre intelektuale e shpirtërore. Kur politika menaxhohet prej atyre që janë në konflikt me artin, është e paevitueshme thatësira që vjen në formë të gjuhë së druajt të politikanëve dhe mesazheve pa fije sensi të asaj që ata e thonë në publik.

Tani kur jetojmë në kohën e semiotikës moderne në komunikim dhe në bashkëveprim me një ambient më të gjerë sociale kulturor, politika duhet pa kursyer të shfrytëzojë mimetikën artistike. Por, për ta bërë këtë nevojitet edhe pak guxim qytetar i njerëzve të politikës që nënkupton përfshirjen e atyre resurseve krijuese që mund të mbindërtojnë një realitet më fisnik në përditshmërinë tonë.

Shumë shembuj në botë tregojnë se politika kur e ka patur aleat artin e mirëfilltë, sidomos në aspektin e imazherisë, ka patur sukses në sensibilizimin e diskurseve dhe manifesteve të saja. Pra, po flasim për një aleancë produktesh të caktuara krijuese e politike, por jo për një aleancë pikëpamjesh e autorësh të ndryshëm, sepse po të ishte kështu atëherë kuptimi i artit do të zbehej dhe do të bëhej një vegël qorre e politikës. Fundja arti si qenësim dhe projektim objektiv i botërave subjektive do të funksionojë vetëm atëherë kur ngritet kundër politikës, sidomos kundër trajtave të autoritarizmit dhe imponimit të të vërtetave absolute. Politika do të jetë ajo që do të krijojë parakushte për një ambient bashkëveprimi, por pa kusht që ajo të bëhet padrone dhe zaptuese e gjithë jetës publike.

KAPITULLIMI I EDVINIT PËR ÇËSHTJEN ÇAME

"Të dashur miq, Ministri i jashtëm i Greqisë informoi një deputet grek me një letër të botuar në media, se në negociatat me Ramën dhe Ditzium e tij ai jo vetëm ka siguruar fushat e gazit dhe naftës më të mëdha të Jonit dhe Mesdheut për Greqinë, por edhe se me palën shqiptare kanë rënë dakord që të fshihen nga faqja e dheut fjalët "çam" dhe "Çamëri", të zhduken këto fjalë nga tekstet, botimet, nga historia jonë kombëtare, gjeografia, debatet dhe çdo gjë tjetër.

Kjo kërkesë për palën greke përben kërkesën më albanofobe, fundamentaliste, të pashembullt në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe unë e kam denoncuar këtë me forcën më të madhe. Por vet diskutimi dhe pranimi i kësaj kërkesë nga Edvini dhe Ditziu i tij është kapitullimi më poshtëruar i regjistruar ndonjëherë në historinë tonë. Me këtë akt të paimagjinueshëm, Rama dhe Ditziu i tij kanë tejkaluar edhe masakrat e Zervës dhe barbaritë e Enver Hoxhës ndaj popullatës të martirizuar të Çamërisë dhe dheut shekullor të saj.

Edi Rama dhe Ditziu i tij kanë shkëputur mbi gjakun, vuajtjen, sakrificat mbinjerëzore të çamëve, kontributin e tyre të pavdekshëm në historinë tonë kombëtare, por edhe në lirinë e kombit grek, themelimin dhe konsolidimin e Greqisë së lirë dhe të pavarur.

Duke dënuar me ashpërsinë më të madhe këtë akt të një tradhtie të pashembullt në historinë e kombit tonë, këtë pabesi dhe thikë të tmerrshme mbas shpine ndaj çamëve dhe Çamërisë së martirizuar, u bëj thirrje shqiptarëve të ngrihem në revolta kundër kësaj klike neoblokmenësh, që për karrikën e vet janë gati të shesin në treg jo vetëm çamët dhe Çamërinë, por edhe identitetin e kombit shqiptar!", shkruan në profilin e tij në FB, Sali Berisha.

"NACIONALIZMI" KORRUPTIV

"Në 25 vitet e fundit, Ballkani post-komunist inauguroi një ideologji të re: 'nacionalizmin korruptiv'. Elitat shtetërore pasuroheshin, duke i shitur masave - opiumin nationalist. Në treg ishin nxjerrë idetë e mëdha për: kombin, flamurin e kufijtë. Por, ky 'nacionalizëm', më së paku qe ideologji, aq më pak atdhetare; por një profesion pasurues.

Ai nuk mbylli asnjë çështje të hapur kombëtare, vetëm hapi kontot e shumta personale. I pari, filloi Millosheviqi, të cilit shitja e virusit serbo-madh i solli 2 miliardë dollarë. Si ky - pa i gëzuar përfundoi edhe Tugjmani, kurse pasuesi i tij Sanader-i gëzoi, deri sa , nuk zëvendësoi foteljen e Kryeministrit, me qelinë e burgut. Edhe "baba" i pavarësisë sllovene - ish kryeministri Jansha ishte në burg - po për korrupsion; sikur që po gjykohej edhe ish kryeministri maqedonas Gruevski. Në Shqipëri, vetingu po nxjerr dyshimet për shumtë milionëshe të ish kryeministrit Berisha. Po në Kosovë? Vërtet, nuk paska: as 'nacionalizëm' e as korrupsion?", shkruan në profilin e tij në Facebook, ish-ambasadori, njëherësh profesor universitar, Blerim Reka.

MEDIACitate

Pas dy dështimeve të njëpasnjëshme të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi, në mungesë të konsensusit të brendshëm politik bashkësia ndërkombëtare po kërkon nga subjektet politike që sa më shpejt ta përmbyllë këtë çështje. Zyrtarë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, nga Ambasada e Gjermanisë, si dhe nga Komisioni Evropian kanë thënë se ratifikimi i Demarkacionit është hap vendimtar në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ambasadori i amerikan në Kosovë, Greg Delawie, pas shtyrjes së seancës për Demarkacionin për të mërkurën e ardhshme ka kërkuar nga partitë politike që të arrijnë një marrëveshje për të ratifikuar Marrëveshjen e Vjenës. Ai ka thënë se partitë duhet të bëjnë marrëveshje që i vendos qytetarët në radhë të parë. "Tani është koha që të gjitha partitë politike të demonstrojnë lidërsip. Bëni një marrëveshje që i vendos qytetarët në radhë të parë. Kaloni Marrëveshjen e Demarkacionit", ka shkruar Delawie në llogarinë e tij në "Twitter". Edhe Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë përmes një përgjigjeje për gazetën "Zëri" ka inkurajuar partitë politike për të arritur konsensus rreth kësaj çështjeje. Kjo Ambasada ka potencuar faktin se ratifikimi i Demarkacionit është hap vendimtar për liberalizimin e vizave për kosovarët. "Ratifikimi i Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit është një hap vendimtar drejt arritjes përfundimtare të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Me ngulm inkurajojmë partitë politike të bashkëpunojnë dhe të arrijnë një konsensus. Arritja e një konsensusi është në interesin e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe duhet të merret si përgjegjësi e përbashkët për këtë vend", thuhet në përgjigjen e Ambasadës së Gjermanisë. Ndërsa zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Kocijançiq, ka thënë për "Zërin" se në Bashkimin Evropian është mirëpritur marrëveshja e presidentit të Kosovës Hashim Thaçi me presidentin e Malit të Zi për çështjen e demarkacionit. (Gazeta Zëri, 26 shkurt)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH QUHEJ "SUBASH"?

Subash quhej funksionari ushtarak osman, komandant në një kaza, qytet ose nahije. Mbante rendin e qetësinë atje ku kryente detyrën dhe në kohë lufte merrte pjesë me repartin e tij në veprime luftarake. Më 1438 Skënderbeu ishte subash i vilajetit të Krujës. Në shek.XV subashi

varej nga sanxhakbeu. Në shek.XVI subashët u shndërruan në funksionarë administrativë, kryesisht nëpër feudet ushtarake dhe në çifligje, si përfaqësues të pronarëve të tyre. Subashët të tillë janë të përmendur për grabitjet e mëdha të të ardhurave mbi sasinë e caktuar të detyrimeve.

Debati rreth Ligjit për gjuhët ka përfunduar dhe se Ligji, sipas deputetit Artan Grubi, do të votohet këto ditë, që jep të kuptojë se Parlamenti nuk do diskutojë fare në lexim të tretë rreth amendamenteve të VMRO-së

ÇËSHTJE DITËSH KUR LIGJI PËR GJUHËT TË VOTOHET NË PARLAMENT

AMENDAMENTET DO TË PËRFUNDOJNË NË KONTEJNER

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 26 shkurt - Mbi 35 mijë amendamentet e parashtruara nga VMRO rreth Ligjit për përdorimin e gjuhëve me gjasë do të mund të përfundojnë në kontejner. Kjo, bazuar në akuzat e VMRO-së ndaj shumicës parlamentare se si këto amendamente janë arkivuar, përkthyer dhe shtuar deri më tani nga shërbimet parlamentare. Mundësia është që të jetë sabotuar "ofensiva me amendamente" nga vetë VMRO, deklaroi Artan Grubi, kryetar i Komisionit për çështje evropiane, përmes të cilit Ligji për gjuhët kaloi më herët me shenjën e BE-së. Siç tha Grubi, debati rreth Ligjit për gjuhët ka përfunduar dhe se Ligji, sipas tij, do të votohet këto ditë, që jep të kuptojë se Parlamenti nuk do diskutojë fare në lexim të tretë rreth amendamenteve të VMRO-së. Ai akuzoi VMRO-në për patriotizëm të rrejshëm ndërkaq sugjeroi se në Komisionin e Venecias do të dërgohen për mendim vetëm nenet që kanë të bëjnë me uniformat ushtarake, bankënotat dhe letrat me vlerë, meqë sipas Grubit, në marrëveshjen me LSDM-në nuk qëndron se i tërë Ligji do të shkojë në Komisionin e Venecias. Në



VMRO ndërkaq nuk kanë një qëndrim të qartë rreth Ligjit për gjuhët që ishte pika kryesore e marrëveshjes për bashkëqeverisje me LSDM-së dhe BDI-së. Koordinatori i ri i grupit parlamentar të VMRO-së, Dragan Danev, tha se nuk duhet të ekzagjerohet kjo dhe se deputetët opozitarë do të koordinohen dhe do të dalin me një qëndrim përfundimtar kur Ligji të shkojë direkt në votim. Danev tha se nuk kanë pasur biseda me LSDM-në rreth këtij ligji, meqë siç tha ai, par-

tia në pushtet hodhi poshtë kërkesën që për Ligjin e gjuhëve, të formohet grup i ri punues nga të gjitha partitë parlamentare. "Shpresoj që LSDM të mos e lejojë miratimin e Ligjit për gjuhët për të cilin mendojmë se është kundërkushtetues dhe i njëjti të silltet përsëri kundër procedurës dhe rregullores së punës. Debati rreth amendamenteve për Ligjin nuk ka përfunduar, për shkak se në lexim të tretë - çdo deputet ka të drejtë të propozojë amendamente

rreth Ligjit lidhur me vërejtjet e Presidentit të shtetit", theksoi Danev. Ai përsëriti qëndrimin se grupi parlamentar i VMRO-DPMNE, i cili ka qenë në bojkot për disa muaj, do të kthehet në Parlament vetëm për Ligjin mbi gjuhët, pra për debatin e mbi 35.000 amendamenteve të tyre. Që ligji të kalojë pa debat, për herë të parë dha shenja kryeparlamentari Talat Xhaferi para dy javëve gjatë brifingut që pati me gazetarët. Xhaferi tha se për të gjitha amendamentet



Grubi akuzoi VMRO-në për patriotizëm të rrejshëm, ndërkaq sugjeroi se në Komisionin e Venecias do të dërgohen për mendim vetëm nenet që kanë të bëjnë me uniformat ushtarake, bankënotat dhe letrat me vlerë, meqë sipas tij, në marrëveshjen me LSDM-në nuk qëndron se i tërë Ligji do të shkojë në Komisionin e Venecias

-vërejtjet janë se të gjitha nenet e ligjit janë antikushtetues, ndërsa sipas tij, Parlamenti nuk është kompetent të vlerësojë kushtetueshmërinë e tyre. Nga VMRO thanë se në këtë rast, Xhaferi shfuqizon rolin e Parlamentit. Ndërkaq në Konferencën e fundit për shtyp, Talat Xhaferi tha se 11 shkurti është afati i fundit për debatin mbi amendamentet e Ligjit për gjuhët, ndërsa agjenda është ndërprere më 30 janar dhe nuk ka vazhduar më tej.

AMBASADORI AMERIKAN CODET PROKURORINË

NEPOTIZËM NË PROKURORI

Shkup, 26 shkurt - Ambasadori i SHBA-ve në Maqedoni, Xhes Bejli, ka kritikuar punën e Këshillit të Prokurorëve Publik, pas publikimit të lajmit se kryetari i Këshillit ka qenë pjesë e vendimit për zgjedhjen e mbesës së tij për prokurore në Prokurorinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion. Ashtu siç tha Bejli, në Këshillin për Prokuror Publik ka konflikt të interesave dhe nëse ndonjë medium nuk do të ishte i guximshëm që ta shkruaj këtë, opinioni nuk do ta dinte.

"Opinioni dhe profesionistët humbën edhe disa gramë besueshmëri ndaj sistemit. Disa gazetarë e kanë punuar këtë rrëfim, vijmë deri në moment se mediat e guximshme dhe shoqëria civile kanë rol të rëndësishëm në sundimin e së drejtës", tha Bejli, duke folur për gjyqësorin në konfe-



rencën e Komisioneve për Integritet Evropiane të Shteteve të Përfshira me Procesin e Stabilizim Asociativ të Evropës Juglindore -

KOSAP, që të hënën u mbajt në Shkup. Deklarata e Bejlit ka të bëjë me lajmin që e shpërndanë mediat, se prokurorja Fidanka Rajev-

ska ka votuar në mbledhjen kur ka qenë zgjedhja e koleges së saj, Lidija Raiçeviq, e cila penalisht e ndjek bashkëshortin e saj për larje

parash. "Më duket se këtu bëhet fjalë për një situatë të konfliktit të interesit. Askush saktë nuk e di se çfarë po ndodh në atë situatë", tha Bejli. Sundimi i së drejtës, thotë ambasadori Bejli, është njëra nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet vendi, ndërkaq shumë shpesh vendet bëhen të rrezikuara nga krimi dhe korrupsioni për shkak të mungesës së sundimit të ligjit.

"Qytetarët duhet që të kërkojnë llogaridhënie, transparencë dhe informim nga ana e institucioneve. Ajo nënkupton se qytetarët duhet ta kthejnë shikimin nga ana tjetër kur të përballen me shkelje të ligjeve dhe me korrupsion, a ajo nënkupton se nuk duhet që të pranohen punët ashtu siç janë nëse nuk jeni të përballur me nepotizëm dhe fenomene të ngjashme", tha Bejli.

"Nëse jemi sadopak autokritikë, do të pranojmë se kur bëhet fjalë për rolin mbikëqyrës të Parlamentit mbi pushtetin ekzekutiv, e posaçërisht për kontrollin mbi harxhimin e parave nga qesja shtetërore, ne mbetemi prapa asaj që është praktikë në vendet e zhvilluara demokratike", tha Xhaferi

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 26 shkurt - Pa kontroll efikas të Parlamentit mbi buxhetin - qesen shtetërore, nuk mund të flasim për demokraci të vërtetë parlamentare, respektivisht për kontroll ndaj pushtetit ekzekutiv. Nëse kjo mungon, pushteti ekzekutiv bëhet i fuqishëm dhe tjetërskohet me çka krijon kushte të favorshme për rritjen e korrupsionit. Këtë e theksoi kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi në hapjen e Konferencës Interparlamentare në temën "Fuqia e qeses: Autorizimet dhe procedurat buxhetore në Parlamentin Evropian" që filloi sot në Parlamentin e Maqedonisë. Ai theksoi se në Republikën e Maqedonisë duke u nisur nga aspekti normativ, siç është ekzistimi i ligjeve përkatëse nga kjo problematikë si dhe të Rregullores së Parlamentit dhe mundësitë që i jep për kontroll parlamentar mbi buxhetin, ndoshta nuk jemi edhe aq keq. "Ekzistojnë më shumë mekanizma dhe forma për këtë, siç është roli i Komisionit për financim dhe buxhet gjatë miratimit dhe riba-

KONFERENCË INTERPARLAMENTARE PËR BUXHETIN E SHTETIT

PARLAMENTI TË JETË KONTROLLUES I QESSES SHTETËRORE



lancit të buxhetit, shqyrtimit dhe miratimit të llogarisë përfundimtare të Buxhetit, institutit të pyetje të deputetëve, rishikimit të raportit vjetor të Entit Shtetëror për Revizion, si dhe mundësia për seanca mbikëqyrëse", thotë Xhaferi.

Sipas tij, qëndron e hapur çështja se sa si Parlament i shfrytëzojmë në mënyrë efektive këto mundësi të rregullores dhe mundësitë ligjore për kontroll si për atë se si mblidhen dhe si harxhohen paratë e qytetarëve. "Nëse jemi sadopak autokritikë, do të pranojmë se kur bëhet fjalë për rolin mbikëqyrës të Parlamentit mbi pushtetin ekzekutiv, e posaçërisht për kontrollin mbi harxhimin e parave nga qesja shtetërore, ne

mbetemi prapa asaj që është praktikë në vendet e zhvilluara demokratike. Prandaj, rolin mbikëqyrës të Parlamentit mbi harxhimin e buxhetit dhe në përgjithësi mbi pushtetin ekzekutiv, nuk duhet ta shohim si edhe një udhërrëfyes ose bençmark nga Brukseli, por si një nga parimet themelore të demokracisë së shtetit juridik, bile nëse dëshironi edhe si vlerë demokratike", tha spikeri i Parlamentit Xhaferi.

Eurodeputeti dhe anëtarë i Komitetit për punë të jashtme në Parlamentin Evropian, Igor Sholtes, në fjalën e tij e theksoi Strategjinë e re të BE-së për zgjerim dhe euro perspektivë të qartë për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe gati-

shmërinë e BE-së për të ecur së bashku këtë rrugëtim. Përkujtoi se nga viti 2007 deri në vitin 2017, BE-ja për ndihmë në rajon ka investuar mbi dhjetë miliardë euro, ndërsa për këtë vit janë paraparë më shumë se një miliardë euro për IPA të cilat do të jenë edhe më të përshtatshme për nevojat e vendeve. Kjo strategji do të kërkojë rritje të financimit, por dhe kontroll më të madh buxhetor për të parë se si, ku dhe për çfarë harxhohen këto mjete. Nuk është me rëndësi vetëm të fitohet granti dhe paratë për vendet, por të ndiqet rruga e këtyre parave për të gjetur sinjalin e çfarëdo rreziku për korrupsion i cili ndoshta ekziston apo çfarëdo parregullish të tjera.

Parlamentet kombëtare luajnë rol kyç në këtë, duke filluar nga komisionet për buxhet, por dhe për kontroll të buxhetit, tha eurodeputeti Sholtes. Ai vuri në dukje përvojën e Sllovenisë ku roli kontrollues i Parlamentit është rreziku përmes formimit të Komisionit për kontroll të buxhetit, i cili bashkëpunon me institucionin për revizion, por nuk është me rëndësi vetëm për kontroll të buxhetit shtetëror, por dhe për kontroll të buxhetit të komunave dhe në përgjithësi për sektorin publik. Ky, theksoi ai, është një mjet shumë i rëndësishëm që BE-ja të dijë se ka pandanin e vet në parlamentet kombëtar. Në konferencën interparlamentare njëditore me temë: "Fuqia e qeses: Autorizimet dhe procedurat buxhetore të Parlamentit Evropian" organizator i së cilës është Parlamenti i Maqedonisë marrin pjesë deputetë nga Parlamentet e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe eurodeputetët, të cilët do të njihen me procedurat dhe kompetencat gjatë kontrollit të buxhetit të BE-së. Korniza buxhetore e BE-së e përfshinë periudhën brenda shtatë viteve, ndërsa për çdo vit veçmas është miratuar buxhet vjetor. Këtë vit buxheti i BE-së është 155 miliardë euro.

KRYEMINISTRI ZAEV PËR "SHPIGEL"

EMRI PA PËRKTHIM, I PAPRANUESHËM

"Dështimi është i paimagjinueshëm për Maqedoninë, për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në një farë mënyre edhe për BE-në", thekson Zaev në intervistë për Shpigel



Berlin, 26 shkurt - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, në intervistë për "Shpigel"-in gjerman thotë se pret të gjendet zgjidhje me Greqinë për çështjen e emrit, por konsideron se nuk është i domosdoshëm ndryshimi i Kushtetutës dhe se marrëveshja eventuale mund të garantohet me marrëveshje ndërkombëtare. E papranueshme, ashtu siç citon, është ndryshimi i emrit të shtetit me emër i cili nuk do të përkthehet. Zaev thotë se nuk mund të paramendojë dështimin e bisedimeve rreth kontestit

të emrit.

"Nuk dua as të mendoj në atë se nuk do të ketë zgjidhje në kontestin me emrin. Ne duhet ta zgjidhim këtë kontest, sepse vetëm ashtu mundemi më tutje të zhvillohemi, të integrohemi në BE dhe të bëhemi shtet përparimtar me sundimin e së drejtës. Ajo është pozitive për tërë rajonin. Dështimi është i paimagjinueshëm për Maqedoninë, për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në një farë mënyre edhe për BE-në", thekson Zaev në intervistë për Shpigel,

që e transmeton Doçje Vele. Në raport të kërkesave greke për ndryshime të Kushtetutës, kryeministri i Maqedonisë konsideron se kjo është e domosdoshme.

"Nuk shoh asnjë arsye për kërkesën që ta ndryshojmë emrin në Kushtetutë, ajo nuk është dinjitoze. Greqisë i nevojitet partner i besueshëm dhe jo partner pa dinjitet. Kushtetuta mund të ndryshohet, por ato ndryshime sërish munden të ndryshohen. Garancia më e rëndësishme për Greqinë është zgjidhja e kontestit të emrit

të jetë e qëndrueshme. Kjo bëhet me marrëveshje ndërkombëtare, të cilat ratifikohen dhe vlejnë edhe në organizatat ndërkombëtare", citon Zaev. Propozimet të cilat këto ditë dëgjohen nga politikanët grekë, për ndryshimin e emrit të shtetit me emër i cili nuk do të përkthehet, për Zaevin janë të papranueshme.

"Nuk mund të njoh argumente të mençura për diçka të tillë. So do të duhet kjo në praktikë, të mos përkthehet emri ynë? Do të duhet t'i detyrojmë kancelaren gjermane Merkel ose presidentin e SHBA-së, Donald Tramp të na quajnë, për shembull, Severna Makedonija? Shembull të tillë nuk ka askund në botë", potencon Zaev. Pas ndryshimit të emrit të autostradës dhe aeroportit në Shkup, kryeministri i Maqedonisë thotë se nuk planifikohen gjeste të tilla të ngjashme në këtë drejtim, por paralajmëron se komisionet e përbashkëta nga të dy vendet do t'i përpilojnë librat e historisë. I

pyetur nëse Qeveria gjermane duhet në mënyrë më aktive të marrë pjesë në biseda, Zaev thotë se edhe palës së Maqedonisë edhe të Greqisë i nevojitet përkrahje dhe inkurajim.

"Por të bëhet presion ndaj cilësdo palë, nuk është rrugë e drejtë. Askush nuk mund të na e marrë vendimin e pavarur dhe sovran në kontestin me emrin", shton kryetari i Qeverisë së Maqedonisë. Lidhur me pretendimet e mundshme territoriale në të cilat paralajmëron Greqia, Zaev thotë se pretendimet e vetme të Maqedonisë janë kahëzuar drejt plazheve greke.

"Po, ne duam në verë t'i okupojmë plazhet e bukura dhe ishujt grek. Më shumë se një milion banorë të Maqedonisë çdo vit udhëtojnë në Greqi, atje i shpenzojmë paratë tona, e duam Greqinë, ka shumë kontakte mes biznesmenëve dhe turistëve. Por sinqerisht: nuk kemi kurrfarë qëllimesh të tjera", thekson Zaev për "Shpigel".

DSK PA KRITERE TË QARTA PËR VLERËSIMI E SIGURISË

SHQIPTARËT E DISKRIMINUAR TË PARAQITEN NË MPB



Duke e komentuar rastin e fundit, me mos vazhdimin e certifikatave për sigurisë, të Enver Kurtishit dhe dy kolegëve të tij, të punësuar në Aeroportin e Shkupit, Nuhiu thotë se nuk e i përjashton paragjykimet dhe arbitraritetin nga punonjës dhe inspektor të caktuar të DSK-së

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 26 shkurt - Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim i mungojnë kriteret e qarta dhe mirë të definuara që kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të sigurisë dhe me shkallën e sigurisë. Ky është vlerësim i zëvendësministrit për Punë të Brendshme, Agim Nuhiu, i cili duke u përgjigjur në pyetjet për diskriminimin që ju bëhet nëpunësve shqiptarë, me mosdhënien e certifikatave të sigurisë, tha se këto probleme kanë ekzistuar në vazhdimësi dhe të njëjtat janë në zgjidhje e sipër. Duke e komentuar rastin e fundit, me mos vazhdimin e certifikatave për sigurisë, të Enver Kurtishit dhe dy kolegëve të tij, të punësuar në Aeroportin e Shkupit, Nuhiu thotë se nuk e i përjashton paragjykimet dhe arbitraritetin nga punonjës dhe inspektor të caktuar të DSK-së. Puna të cilën e bëjnë këta inspektorë, sipas Nuhiut, përkundër faktit se duhet të bazohen në dispozitat e ligjeve përkatëse, atyre të rendit kushtetues, angazhimi i tyre duhet të mbështet edhe në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, gjegjësisht në dinjitetin njerëzor.

"Kur flasim për çështjen konkrete, me rastin e fundit në Aeroportin e Shkupit, gjatë mbledhjes së ditë së hënë, ne e kemi diskutuar edhe këtë çështje. Kështu që mund të them se ekziston disponimin për të vënë në binarë, jo vetëm këtë çështje, por edhe revidimin e të gjitha çështjeve tjera për të cilat ekzistojnë dyshime se janë vlerësuar në mënyrë arbitrare. Falë kuadrove profesionale në DSK, pavarësisht se a bëhet fjalë për shqiptar apo jo, ne po ia arrijmë qëllimit që këto gabime dhe lëshime t'i përmirësojmë. Kuptohet, me një angazhim plotësues. Për këtë arsye, në mbledhjen e ditës së hënë u vendos që



AGIM NUHIU

Kur flasim për çështjen konkrete, me rastin e fundit në Aeroportin e Shkupit, gjatë mbledhjes së ditë së hënë, ne e kemi diskutuar edhe këtë çështje. Kështu që mund të them se ekziston disponimin për të vënë në binarë, jo vetëm këtë çështje, por edhe revidimin e të gjitha çështjeve tjera për të cilat ekzistojnë dyshime se janë vlerësuar në mënyrë arbitrare

shërbimet e DSK-së të propozojnë dhe të instalojnë një sistem, i cili në të ardhmen 'gabimet' e kësaj natyre nuk do t'i përsëritë. Të gjithë këto kandidatë të cilët janë refuzuar, DSK edhe njëherë, me secilin një nga një, do të zhvillojë bisedë zyrtare, me qëllim shqyrtimin e rrethanave dhe fakteve të cilat kjo drejtori i posedon në bazë të evidencës së saj, ndërsa janë fakte relevante për të vendosur në mënyrë meritore", tha për KOHA zëvendësministri Nuhiu.

Dalja publike e nëpunësve shqiptarë të Aeroportit të Shkupit, të cilët akuzojnë për diskriminimin që u është bërë, i ka nxitur edhe nëpunësit tjerë shqiptarë të institucioneve shtetërore të tregojnë hallin e tyre e që lidhen me mos dhënien e certifikatave të sigurisë. Listës së personave të revoltuar me trajtimin dhe qasjen e DSK-së i janë shtuar edhe disa nëpunës shqiptarë të Ministrisë për Punë të Jashtme. Kështu,

ata shprehen se edhe pse me 10 vite përvojë pune, së fundmi kërkesat për certifikatave të sigurisë ju refuzohen, madje pa u dhënë sqarime për se pse miratohet një vendim i tillë. Numri dy i policisë së shtetit, Agim Nuhiu, për gazetën KOHA mes tjerash ju bëri thirrje të gjithë punonjësve apo qytetarëve, të cilat vlerësojnë se u është bërë padrejtësi nga ana e DSK-së t'i drejtohen personalisht atij, me të vetmin qëllim kycjen në procesin e rishqyrtimit të vendimeve për refuzim të certifikatave të sigurisë.

Ndryshe, përgjatë kohës kur zëvendësministri Nuhiu deklaroi se rasti i fundit në Aeroportin e Shkupit, do të shqyrtohet në mënyrë shtesë, nga Drejtoria për Sigurimin e të dhënave të klasifikuara (DSTK), njoftojnë se për Enver Kurtishin dhe kolegët e tij, nuk është kërkuar inicim i procedurës për ndarjen e certifikatave të sigurisë për qasje deri te të dhënat e klasifikuara. "Në evidencën e bazës së të dhënave të Drejtorisë për sigurimin e të dhënave të klasifikuara, nuk figuron se Aeroporti i Shkupit ka ngritur procedurë për ndarjen e certifikatave të sigurisë për qasjen deri te të dhënat e klasifikuara, për punonjësit e tyre", thonë nga DSTK. Me problemet dhe sfidat kësaj natyre, krahas nëpunësve shqiptarë në institucionet e apostrofuara, gjatë viteve të kaluara janë ballafaquar edhe deputetët. Lidhur me këtë çështje, zëvendësministri Nuhiu tha se të gjithë deputetët, të cilëve u nevojiten certifikatave të sigurisë për realizimin e aktiviteteve ditore, të njëjtëve u janë ndarë tashmë. Në ndërkohë, hesht edhe Aeroporti i Shkupit, zyrtarët e së cilës gazetës KOHA i kanë siguruar se sot (e martë) do të japin sqarime konkrete se çfarë po ndodhë me nëpunësit shqiptarë.

KRONIKË

Gjashtë të lënduar në mbikalimin e lagjes "Dame Gruev"

Gjashtë persona prej të cilëve tre më rëndë janë lënduar në aksident që ndodhi dje rreth orës 17:55 në mbikalimin e lagjes së Shkupit, Dame Gruev. Nga MPB informojnë se dje në orën 17:55 në rrugën "Luka Gerov" në Shkup ka ndodhur aksident mes automjetit motorik "Opel astra" me targa të Shkupit, të drejtuar nga D.T. (60) nga fshati Orman i Shkupit dhe automjeti motorik "Hjundai" me targa të Shkupit, të drejtuar nga K.K.(49) nga Shkupi. "Pas përplasjes, shoferët D.T. dhe K.K. me automjetin e Ndihmës së shpejtë janë dërguar në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori" ku u janë konstatuar lëndime të rënda trupore dhe janë mbajtur për shërim. Bashkudhëtari i automjetit "Opel astra" A.T. është dërguar në Qendrën urgjente në Kompleksin e Klinikave "Nënë Tereza" në Shkup, ku u janë konstatuar lëndimet e rënda trupore dhe është mbajtur për shërim", citohet në buletin policor. Me lëndime trupore në aksident kanë marrë edhe 56 vjeçari B.T. dhe një fëmijë 10 vjeçar të cilët ishin bashkudhëtarë në automjetin "Opel astra", si dhe bashkudhëtarja 15 vjeçare në automjetin "Hjundi". Pas ndihmës së dhënë në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori", ato janë lëshuar për shërim shtëpiak. Kontroll në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB-së Shkup.

Një i lënduar në rrugën Manastir-Resnjë

Një person është lënduar rëndë në një aksident trafiku që ka ndodh dje në rrugën magjistrale Manastir-Resnjë. Ministria e Punëve të Brendshme informoi se aksidenti ka ndodhur në afërsi të udhëkryqit "Makazi" në fillim të vendit të quajtur "Livadhet e Sopotit", dje rreth orës 18, me çrast janë përplasur një veturë e tipit "Daevu" me targa të Shkupit, e drejtuar nga T.M. (43) nga fshati Podmoçan, i Resnjës dhe një veturë "Hundai" me targa të Manastirit, e drejtuar nga D.P. (33) nga fshati Orizare e Poshtme, Manastir. Nga përplasja, shoferi i automjetit "Daevu" ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe është dërguar në Spitalin klinik të Manastirit. Inspektim në vendngjarje ka kryer ekipi nga stacioni policor Resnjë.

Një zjarrfikës lëndohet gjatë shuarjes së zjarrit në Shkup

Një zjarrfikës nga Brigada e Zjarrfikësve Shkup në mëngjesin e djeshëm është lënduar gjatë shuarjes së zjarrit në një ndërtesë banimi në rrugën "Hristian Todorovski Karposh" në Shkup. Zjarrfikësi B.M., informojnë nga MPB, është transportuar në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "Shën Naumi i Ohrit", prej ku orën 03:55 e kanë informuar Njësitin për Informacione dhe Komandë Shkup. Zjarri është shuar. Po ndërmerren masa për konfirmimin e arsyeve për shkaktimin të zjarrit. (O.Xh)

Listat e lekturave shkollorë janë propozuar të kenë dy kategori tituj dhe autorësh. E para është ajo e titujve që duhen punuar patjetër dhe e dyta - e titujve zgjedhor. Nga kasa e dytë deri të nëntën në kategorinë e parë janë 19 tituj, ndërsa në kategorinë e lekturave me zgjedhje janë 58 tituj

Koha Laura PAPARNIKU

Shkup, 26 shkurt - Pas tre dekada-sh, lista të vjetruara të lekturave shkollorë, nga ky vit mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë do të kenë mundësi të punojnë me lista të reja. Në tre mujorin e fundit të këtij viti shkollor, por edhe gjatë pushimeve verore, ata do të mund t'ju japin nxënësve të lexojnë "Princeshën Argjiro" të Ismail Kadare, "Qingjin e vogël" të Bardhosh Gaçes, "Historinë e Skënderbeut" nga Odise Grillo, "Hekurani në Artas" nga Abdylaziz Islami dhe lektura të tjerë nga letërsia shqipe, maqedonase dhe botërore për fëmijë.

Të hënën, ministria Renata Deskovska i ka dhënë dritë jeshile debatit mbi propozim-listën me ti-

PROPOZIM-LEKTURAT NË DEBAT DERI MË 26 MARS

FILLON REVIDIMI I LISTAVE TË LEKTURAVE SHKOLLORE



tujt dhe lekturat e reja të arsimit fillor të përgatitur nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit. Revidimi i listave, është propozuar të bëhet për lëndët e gjuhës dhe letërsisë maqedonase, shqipe dhe turke, pra në gjuhët që kryesisht organizohet arsimin fillor, nga klasa e dytë deri në klasën e nëntë. Lajmi i shumëpritur është kumtuar nga vetë Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) e cila bën ët ditur se "lista e lekturave freskohet dhe plotësohet që të jetë në hap me interesat e nxënësve, respektivisht që ta nxit dhe rit interesin për librin te lexuesit e rinj përmes

ofrimit të përmbajtjeve dhe tekurave të trendëve bashkëkohore dhe interesave të nxënësve", thuhet në kumtesën e MASH-it. Revidimi i listave, thuhet më tej bëhet gjithashtu me qëllim që t'ju jepet liri mësimdhënësve në punën dhe zgjedhjen që do të bëjnë ato me titujt dhe autorët e lekturave.

E veçanta e propozim-listave të lekturave shkollorë të arsimit nëntëvjeçar është se titujt dhe autorëve të librave përkatëse do të janë të disponueshëm në dy kategori, atë të lekturave që mësimdhënësit do ti kenë të obligue-

shëm ti punojnë me nxënësit dhe kategorinë ku mund të zgjedhin ndonjërin prej titujve dhe autorëve të ofruar. Në kategorinë e parë, pra të lekturave që nxënësit duhet ti lexojnë patjetër janë 19 lektura edhe atë nga dy për klasat II dhe III, tre për klasën IV, nga katër për V, VI dhe VII dhe nga pesë lektura të obligueshme për klasat VII, VIII dhe IX. Në kategorinë e lekturave me zgjedhje, arsimtarët e letërsisë kanë të zgjedhin mes 58 titujve të ndryshëm. Listat e ofruara nga BZHA dhe të miratuara nga MASH mund të pësojnë ndryshime, nëse kjo kërkohet nga kom-

petentët, mësimdhënësit dhe palët tjera të interesuara. Pasi propozim-listat e lekturave sikurse bën të ditur MASH janë për momentin në debat publik, ndërsa të njëjtat mund të gjenden në portalin zyrtar të kësaj Ministrie. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve për ndryshime eventuale në këtë listë është 26 marsi. Pas kësaj MASH do të del me listët përfundimtare të lekturave shkollorë, të cilat në Maqedoni nuk kishin pësuar ndryshime që në vitin 1988. Lista janë të ndryshme, varësisht gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

NË BOZOVCË GATI PËR FESTË

KARNAVALET ILIRE, DHJETË VJET NGA RIKTHIMI I TRADITËS

Dhjetëvjetori i rikthimit të traditës për zhvillimin e karnavalit këtë vit do të shënohet me një pjesëmarrje më të gjerë studiuesish nga Kosova e Shqipëria, institutesh e katedrash universitare, program artistik e të tjera

Koha Evis HALILI

Shkup, 26 shkurt - Përgatitjet për edicionin e sivjetshëm të Karnavaleve ilire të Bozovcës që do të mbahet më 11 mars - janë drejt fundit. Dhjetëvjetori i rikthimit të traditës për zhvillimin e karnavalit këtë vit do të shënohet me një pjesëmarrje më të gjerë studiuesish nga Kosova e Shqipëria, institutesh e katedrash universitare, program artistik e të tjera. Organizatorët e



këtij manifestimi pohojnë se brenda mundësive janë përpjekur që pjesëmarrja të jetë më masive, duke iu përgjigjur kështu interesimit të studiuesve nga jashtë vendit për të qenë pjesë e karnavaleve ilire, të njohura për formën unike me të cilën shënohet kalimi nga një stinë në tjetrën dhe që nuk haset në karnavalet që zhvillohen në trevat e tjera shqiptare. Ritet në Malësinë e Sharrit, krahasimi me popujt e tjerë dhe manifestimeve të tjera të ngjashme do të jenë pjesë e tribunës shkencore me të cilën para-

shikohet të hapet programi festiv. Si pika të tjera të programit krahas performansave me këngë e valle nga këngëtarë e ansamble nga Shkupi e Tetova do të jenë edhe ritualet karnevaleske, që me ndryshime të vogla prezantohen në formën e tyre autentike.

"Asgjë nuk ka ndryshuar në përmbajtjen e karnavaleve të cilat mundohemi që t'i ruajmë ashtu siç i kanë organizuar të parët tanë. Këtë vit shënojmë dhjetë vjet që nga rifillimi i traditës së karnavalit që pati një ndërprerje të gjatë dhe

besojmë se do të vazhdojmë kësh-tu pa ndërprerje. Kjo ngjarje është e rëndësishme pasi me të tregojmë vlerat, traditat që të tjerët mundohen që t'na i mohojnë", thotë një prej organizatorëve kryesorë Neshat Mehmedi. I vetmi ndryshim dhe element i ri që është prezent për dy vjet me radhë është përfshirja e gjinisë femërore në ritualet e karnavalit. Nëse vitet e kaluara roli i gruas kufizohej brenda shtëpisë dhe gatimeve tradicionale, ndërsa gratë zëvendësoheshin me meshkuj që i imitonin, vjet rituali i

nusërimit (teleisjes) realizohet nga tre gra, që këtë vit do të jenë shtatë. Pikat e tjera të karnavaleve kanë si protagonistë meshkuj, paradë me meshkuj të veshur me rroba të endura me lesh, të kombinuara me lëkurë dhe gëzofë kafshësh, brirë, e të tjera. Karakteristike dhe unike cilësohen maskat zoomorfe të cilat sipas studiuesve paraqesin një ndërlidhje midis të gjallëve dhe të vdekurve, me një periudhë që shënon pikëtakimin mes kaosit dhe kozmosit, si edhe kali i drurit. Sa i takon tematikës së këngëve dhe valleve që interpretohen ato kryesisht lidhen me përditshmërinë lindjet, vdekjet, mërgimin, dasmat e të tjera.

Karnavalet ilire të Malësisë së Sharrit konsiderohen si më të vjetrat në Ballkan dhe më parë janë shënuar edhe në fshatra të tjerë, si Liseç, Veshalla dhe Shipkovicë, por tradita vitet e fundit ruhet vetëm nga banorët e Bozovcës. Simbolizon ndërrimin e stinëve, kalimin nga dimri në pranverë dhe mënyrën sesi banorët bëhen gati për të nisur një jetë të re dhe për të larguar të këqijat.

FORUM I INVESTIMEVE TË BERZH-it NË LONDËR

"Gjithashtu punojmë në projektin hekurudhor, infrastrukturë e cila do ta lidhë Bullgarinë me Republikën e Maqedonisë. Presidenti i BERZH-it shtoi se bëhet fjalë për të ashtuquajturën 'Magjistranja e Miqësisë- Serbi, Bullgari, Romani, Kosovë dhe Maqedoni', tha Çakrabarti

RRETH 30 MILIARDË EURO KUSHTOJNË KORRIDORET NË BALLKAN

Londër, 26 shkurt - Rreth 30 miliardë euro do të kushtojnë ndërtimi i korridoreve transportuese të Ballkanit Perëndimor, deklaroi të hënën kryeministri i Bullgarisë Bojko Borisov në hapjen e Forumit të investimeve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Londër. Ai shtoi se edhe rreth pesë miliardë euro do të kushtojnë ndërtimi i infrastrukturës dixhitale në rajon. Korridoret kryesore të cilat janë në fokus të takimit të sotëm, janë numrat katër, tetë dhe dhjetë.

"Plani, të cilin e propozojmë, është i pranueshëm për secilin nga shtetet. Kur ka korridore të tilla transportuese, secili kryeqytet do të ketë qasje në të përmes linjës hekurudhore dhe autostradës dhe internetin", theksoi Borisov. Kryeministri i Bullgarisë informon se në takimin e liderëve nga Ballkani Perëndimor me presidentin e KE-së, Zhan Klod Junker, i cili do të mbahet më 1 mars në Sofje, do të paraqiten të gjitha projektet. Atëherë, secili nga gjashtë liderët do të publikojnë se si do të financohen këto projekte. Presidenti i Bankës Evropiane për Rindërtim

dhe Zhvillim, Suma Çakrabarti në hapjen e forumit theksoi se BERZH-i do të vazhdojë t'i përkrahë projektet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor. Që sot do të nënshkruhet Memorandumi për financimin e projektit C-5 për vitet e ardhshme. Banka gjithashtu do ta përkrahë mbarimin e korridoreve transportuese tetë dhe dhjetë. "Gjithashtu punojmë në projektin hekurudhor, infrastrukturë e cila do ta lidhë Bullgarinë me Republikën e Maqedonisë. Presidenti i BERZH-it shtoi se bëhet fjalë për

të ashtuquajturën 'Magjistranja e Miqësisë- Serbi, Bullgari, Romani, Kosovë dhe Maqedoni', tha Çakrabarti. Para disa ditëve ishte nënshkruar marrëveshje për financimin e 38,5 milionë eurove lidhur me këtë projekt, informon Çakrabarti. Presidenti i BERZH-it shtoi se me TANAP janë nënshkruar marrëveshje për financimin e projektit TAP. Në këtë mënyrë gazi i Kaspikut mund të kalojë nëpërmjet Ballkanit dhe Evropës Perëndimore. Sipas tij, përveç ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme në rajon, duhet të for-

mohen kushtet e domosdoshme për tregun e vetëm të investimeve, i cili përfshin përshtatjen e rregullave, tarifave, sigurimin e kushteve të nevojshme për investimet e huaja.

"E gjithë kjo do të kontribuojë në zhvillimin e fushës ekonomike në Ballkan. Banka gjithmonë është e gatshme për zgjidhje praktike", theksoi Çakrabarti. Është parashikuar edhe formimi i bursës për lidhje të vendeve ballkanike. Ky është forumi i tretë kushtuar Ballkanit Perëndimor.

BERZH: INVESTIME TË REJA DHE INTEGRIM EKONOMIK I BALLKANIT PERËNDIMOR

Interes i intensifikuar dhe fluks i investimeve të huaja në Ballkanin Perëndimor është qëllimi i "Platformës investuese rajonale" të BERZH-së që sot u promovua në Samitin investues londinez për Ballkanin Perëndimor në organizim të Bankës Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim (BERZH), në të cilën morën pjesë Kryeministri Zoran Zaev dhe kryeministra nga rajoni. Ideja e nismës është t'i ofrojë potencialet e rajonit, por edhe secilit vend veçmas, në suaza të kapaciteteve të tyre të bashkuara, si resurs dhe treg prej mbi 20 milionë banorëve. "Platforma investuese rajonale" e re, siç qëndron në kumtesën nga shërbimi qeveritar

për informim, do t'i përfaqësojë përparësitë e rajonit para investuesve të huaj dhe do t'i bashkojë të gjitha lehtësimet dhe mundësitë për investime të huaja të reja nga karakteri rajonal. Në konferencën për media pas promovimit, interes është shprehur për politikën për luftë kundër korrupsionit në të gjitha vendet nga Ballkani Perëndimor, dhe lidhur me ndërlidhjen energjetike. Kryeministri Zoran Zaev theksoi se lufta kundër korrupsionit është prioritet në politikën e Qeverisë të RM-së dhe se politikën për ballafaqim me këtë dukuri do të vazhdojnë të implementohen me intensitet më të madh.

Rezultate të këqija ekonomike, shkak i politikave të gabuara qeveritare

Shkup, 26 shkurt - Kryetari i VMRO-DPMNE-së Hristian Mickoski gjatë ditës së hënë do të realizojë takim me tre eurodeputetët, Kukan, Vajgëll dhe Flekenshtajn. Në takim do të bisedohet për situatën aktuale politike në vend. "Por, ajo që është më e rëndësishme për qytetarët është gjendja e vështirë ekonomike e secilit prej tyre veçmas, që është rezultat i politikave të gabuara dhe këqija të cilat qeveria e udhëhequr nga LSDM-ja i praktikon në Republikën e Maqedonisë. Në vazhdim do të përmendi disa argumente dhe fakte në të cilat bazohet analiza ime. BPV-ja në tre tremujore e para është diku 0,4 për qind nën zeron, që do të thotë se ka rritje negative, ndërsa deri në fund të vitit do të ishim të lumtur nëse përfundojmë me zero. Që paraqet një prej arritjeve më të këqija nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë e deri më sot", thuhet në kumtesë.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, shtohet më tej, "janë për 11 për qind më të varfër më 31 dhjetor të vitit 2017, krahasuar me atë që ka qenë në 31 dhjetor të vitit 2016". "Kjo qeveri kriminele dhe e paaftë duhet të largohet. Vjen shpresë e re për Republikën e Maqedonisë", thuhet në kumtesën e kryetarit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski.

REAGON SHGM

IVANOVI PO CENON LIRINË E MEDIAVE



Shkup, 26 shkurt - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë shpreh shqetësim serioz që kabineti i presidentit Gjorgje Ivanov në periudhën e kaluar u ka ofruar

certifikata të sigurisë disa gazetarëve, duke u shpjeguar se dëshirojnë të rrisin transparencën e institucionit. "Kemi informata serioze se pjesa më e madhe e gazetarëve që janë ftuar në brifing në kabinetin e Presidentit kanë nënshkruar kërkesat për marrjen e certifikatës për siguri, duke mos pasur mundësi të informohen për drejtat dhe obligimet e bartësve të certifikatës, dhe për atë se si do

të ndikojë ajo në punën e tyre. Ne besojmë se ndarja e certifikatave të tilla për gazetarë, nga ana e shërbimeve të sigurisë paraqet presion mbi profesionin e gazetarëve, dhe me atë gazetarët nga mbrojtës të interesit publik shndërrohen në nëpunës shtetërorë. Veprimi i tillë i presidentit Ivanov e cenon lirinë e mediave, sepse lidhja e gazetarëve me shërbimet për siguri vetëm do ta

përforcojë vetë-censurën", ka thënë kryetari i SHGM-së, Naser Selmani.

I bëjmë thirrje presidentit Gjorgje Ivanov menjëherë t'iu jep urdhër këshilltarëve të tij të ndalojnë procesin e ndarjes së certifikatave të sigurisë për gazetarë. Nëse presidenti dëshiron të rrit transparencën atë mund ta bëjë me kontakte më të shpeshta me gazetarët dhe me publikimin e të

gjitha informatave me karakter publik me të cilët disponon institucioni. "Gjithashtu, iu bëjmë thirrje kolegëve menjëherë të heqin dorë nga kërkesat për marrjen e certifikatave sepse kjo është në kundërshtim me Kodin e gazetarëve. Ai na obligon t'i respektojmë ligjet në vend, por gjithashtu kërkon nga nesh të mos fshehim informata që janë në kundërshtim me interesin publik".

Banorët e këtyre fshatrave të revoltuar ankohen se rruga nuk është pastruar siç duhet, andaj edhe njëherë apelojnë deri tek komuna që të ndërmarrë masa për pastrimin e kësaj rrugë nga dëbora që të mund të qarkullojnë lirshëm dhe pa vështirësi

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 26 shkurt - Pas reshjeve të dendura të borës në shumë rrugë të qytetit dhe rrethinës së Tetovës, komunikacioni zhvillohet në kushte dimërore dhe me shumë vështirësi. Gjendja më e vështirë është në rrugët që shpiejnë për në fshatrat e Malësisë së Tetovës, si në fshatin Shipkovicë, Brodec dhe Veshallë. Automjetet në këtë rrugë që shpie për në këto fshatra qarkullojnë me shumë vështirësi për shkak të mospastrimit si duhet të rrugës. Banorët e këtyre fshatrave të revoltuar ankohen se rruga nuk është pastruar siç duhet, andaj edhe njëherë apelojnë deri tek komuna që të ndërmarrë masa për pastrimin e kësaj rrugë nga dëbora që të mund të qarkullojnë lirshëm dhe pa vështirësi. "Makinaria ka-

RRUGËT ME VËSHTIRËSI KALOHEM



MALËSIA E TETOVËS TELASHE ME BORËN

lon, por pastrimi nuk është i mjaftueshëm, nuk pastrohet si duhet. Si duket vetëm kalojnë sa për sy e faqe, por jo edhe të pastrojnë në mënyrë të mirëfilltë rrugët. Në këtë rrugë që kalon për në fshatin tonë dhe më pas vazhdon për në fshatrat Brodec, Veshallë, Bozovcë, gjithmonë ka vështirësi në dimër, sepse mirëmbajtja duhet të jetë më e mirë për shkak se bie më shumë borë", thonë banorët e fshatit Shipkovicë. Situata e njëjtë paraqitet edhe në rrugën që shpie për në fshatin Lisec të Tetovës, ku në këtë rrugë mund të kalojnë vetëm ato automjete që kanë goma të mira dimri dhe pajisje dimërore për shkak se rruga në shumë pjesë

është mbuluar me dëborë. Nga Komuna e Tetovës thonë se prej mbrëmë kanë dalur në terren. "Aksioni për pastrimin e rrugëve në territorin e Komunës së Tetovës, bulevardet kryesore, rrugët dytësore si dhe rrugët që lidhin fshatrat e Malësisë së qytetit ka nisur që në orët e mbrëmjes duke vazhduar deri në orët e mëngjesit e që është në vazhdim e sipër", thonë nga Komuna e Tetovës. Nga Komuna informojnë se të gjitha rrugët janë të kalueshme. "Për momentin nuk kemi ndonjë rrugë të pakalueshme, të gjitha janë të kalueshme dhe lëvizja e qytetarëve bëhet pa asnjë problem, ndërkohë që për shkak të të reshurave të shumta të

borës dhe makinave të vendosura dhe parkuara, kemi hasur në disa vonesa dhe pengesa të vogla për pastrimin e disa rrugëve dhe rrugicave nëpër qytet, përndryshe aksioni është në vazhdim e sipër", njoftuan nga Komuna e Tetovës. Në ndërkohë, edhe gjatë natës së kaluar janë shfaqur pengesa në rrugën për tek vikend-shtëpizat në Kodrën e Diellit, ku bora nuk është pastruar dhe kjo krijon vështirësi për banorët që jetojnë në atë pjesë të Kodrës së Diellit. "Në Kodrën e Diellit është intervenuar në mëngjes e për momentin për shkak të të reshurave të borës dhe lëvizjes së madhe të makinave, është e pamundur intervenimi, megjithatë

në orët në vazhdim do të intervenohet në pastrimin e bores", njoftuan nga Sektori për Tokë Ndërtimore dhe Komunikacion në Komunën e Tetovës. Reshjet e dëborës në të gjithë vendin e kanë vështirësuar dhe ngadalësuar qarkullimin rrugor, i cili zhvillohet në rrugë të lagura, me mbetje të dëborës dhe me ndalime dhe kufizime për automjetet e rënda të transportit në qafat malore dhe në një pjesë të rrugëve. Për shkak të paraqitjes së mjegullës, shikimi është zvogëluar nga 15 deri në 20 metra në Kodrën e Diellit. Në fuqi është detyrimi ligjor për posedim të obligueshëm të pajisjeve dimërore në automjete.

Humbi jetën një këmbësor

Shkup, 26 shkurt - Një person ka humbur jetën në njërin nga 27 aksidente të regjistruara gjatë fundjavës në rajonin SPB të Shkupit. Në katër aksidente lëndime të lehta kanë marrë 6 persona në 11 lëndime të lehta kanë marrë tetë persona, ndërsa në 14 aksidente është shkakuar dëm material. Siç informojnë nga MPB-ja, se gjatë fundjavës policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Pesëdhjetë e tetë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, tre shoferë nuk kanë dhënë përparësi për kalimin të këmbësorëve, 20 për parakalim të parregullt dhe tetë shoferë të cilët nuk kanë poseduar pajisje dimërore në automjetet. Janë sanksionuar edhe pesë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimeve për këmbësorë. Nga trafiku janë përjashtuar 12 shoferë për shkak të drejtim të automjetit në ndikim të alkoolit dhe 40 të tjerë janë përjashtuar nga trafiku sepse kanë drejtuar automjetin para se ta marrin të patentën, 10 me automjete të parregjistruara. Janë hasur edhe 243 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 150 automjete.

TË DHËNA SHQETËSUESE TË KLINIKËS PËR GJINEKOLOGJI

PËR DY VITE, 23 ABORTE



Shkup, 26 shkurt - Dy nëna të mitura në periudhën prej vitit 2016 deri tani i kanë braktisur foshnjat e posalindura në Klinikën për Gjinekologji pasi nuk kanë mundur dhe nuk kanë dashur të kujdesen për to. Asnjëra nga ato nuk i përket shtëpive për fëmijë jetim "25 Maji" apo "Ranka Milanoviq", thonë të dhënat e Klinikës. Gjithashtu, dy vajzat nga strehëmorja "25 maj", 13 vjeçarja R.I për

të cilën ka dyshime se ka qenë viktimë e tregtisë me njerëz, si dhe një 15 vjeçare janë të vetmet të cilat kanë qenë nën përkujdesje në strehimore shtetërore dhe i janë nënshtruar abortit. Që të dyja kanë abortuar këtë muaj. Prej vitit 2016 deri tani nuk ka pasur raste të tilla, thonë nga Klinika për Gjinekologji. Sipas të dhënave që i marrim nga atje, për këto dy vite shtatzënia i është

ndërprerë 23 vajzave të mitura. Kjo është përvojë traumatike për to, thonë personat kompetent. "Të miturat të cilat ballafaqohen me shtatzëni të pa dëshirueshme shpesh demonstronë ndjenjë të fajësisë dhe frikës, kanë frikë nga reagimi i prindërve dhe rrethinës. Në klinikën tonë gjithë ekipi punon në përkrahjen e pacienteve të mitura, gjatë kohës së intervenimit dhe qën-

Në fillim të vitit 2018 në Klinikën për Gjinekologji kanë abortuar 4 vajza të mitura. Edhe në vitin 2017 kanë abortuar 4 vajza të mitura, të cilat kanë qenë në muajin e katërt të shtatzënisë. Më së shumti aborte ka pasur në vitin 2016, edhe atë 11

drimit në Klinikë", sqarojnë nga klinika.

Pas abortit, vajzat marrin rekomandime për kontracëpsion dhe u jepet ndihmë e mëtejshme psiko-sociale si përkrahje. Ata marrin edhe një këshillë tjetër - ta vazhdojnë shkollimin. Në fillim të vitit 2018 në Klinikën për Gjinekologji kanë abortuar 4 vajza të mitura. Edhe në vitin 2017 kanë abortuar 4 vajza të mitura, të cilat kanë qenë në muajin e katërt të shtatzënisë. Më së shumti aborte ka pasur në vitin 2016, edhe atë 11, pesë prej të cilave kanë abortuar pas javës së 12 të shtatzënisë. (A.Xh)

Kontrolle në dy bastore në Tetovë

Tetovë, 26 shkurt - Të shtunën rreth orës 15 e 45 minuta, pjesëtarë të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë kanë kryer kontroll në bastoren sportive në rrugën "120" në Tetovë, pronë e 40 vjeçarit S.I. Në objekt janë gjetur dy aparate për poker me lexues, dy televizor dhe diku rreth 1500 denarë, të cilët më pas me vërtetim janë marrë për shkak të dyshimeve se ka organizuar lojëra të fatit pa licencë. Pronari i objektit pas zbardhjes së rastit do të ketë edhe padi adekuate. Në kuadër të aktiviteteve që këtë vit i ka ndërmarrë Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë për zbulimin dhe sanksionimin e organizimit të paligjshëm të lojërave të fatit, të dielën prej orës 16 deri në orën 20, pas marrjes së informacioneve paraprake, ka kryer kontroll në objekt në rrugën "Jane Sandaski", në Tetovë. Në brendinë e objektit janë gjetur tre aparate për lojëra të fat për të cilët pronari J.J. 43 vjeçar nuk ka patur leje, ndërsa më pas janë marrë edhe 15.030 denarë me vërtetim. Pronari i objektit pas zbardhjes së rastit do të ketë edhe padi adekuate. (U.H)

Shkupjani vdes në Mavrovë

Gostivar, 26 shkurt - Të dielën rreth orës 12 e 20 minuta, B.S nga Shkupi, ka denoncuar se në banesën e tyre në Mavrovë, fillimisht i është përkeqësuar gjendja dhe më pas ka vdekur në dhomën e gjumit 61 vjeçari PS poashtu nga Shkupi. Me urdhër të Prokurorit Publik ekipet e Policisë së Gostivarit kanë kryer hetime, ndërsa gjatë ditës së sotme trupi i pajetë i është dorëzuar familjes për varrim.

GANIU NIS PROJEKTET PËR ZGJERIMIN E SHKOLLAVE



DO TË SHTOHEN KLASAT NË "LIRIA" DHE "ISMAIL QEMAJLI"

Gjatë vitit vijues, gjithashtu Komuna e Çairit do të rinovojë gati se të gjitha shkollat fillore, të cilat janë në territorin e saj, e për të cilat Ganiu thotë se janë siguruar edhe mjete nga buxheti i vitit 2018

Shkup, 26 shkurt - Numri i madh i nxënësve ka bërë që Komuna e Çairit të mendojë në shtimin e klasave apo zgjerimin e disa objekteve shkollore që gravitojnë në territorin e saj. Fillimisht po përgatitet dokumentacioni për shtim të klasave në shkollën fillore "Liria" dhe "Ismail Qemajli". Lajmin në fjalë për gazetën KOHA e konfirmon kryetari i Çairit, Visar Ganiu, sipas të cilit, përveç zgjerimit, do të bëhet edhe renovimi i shkollave në këtë territor. "Kemi filluar të përgatisim dokumentacionin për zgjerime nëpër shkolla, kemi të drejtë deri 20 për qind për ndryshime prej planit ekzistues që është shkolla. Do të thotë, të bëjmë edhe zgjerime, kështu që na nevojiten hapësira të reja në shkollën fillore 'Ismail Qemajli' dhe shkollën fillore 'Liria', dhe ne jemi duke hartuar gjitha ato projekte që në të

ardhmen - të bëjmë zgjerimin e tyre me të vetmin qëllim - të rrisim hapësirat në këto shkolla, sepse është më se e nevojshme për mbarëvajtjen e mësimin dhe për ti sistemuar nxënësit", tha Ganiu. Gjatë vitit vijues, gjithashtu Komuna e Çairit do të rinovojë gati se të gjitha shkollat fillore, të cilat janë në territorin e saj, e për të cilat Ganiu thotë se janë siguruar edhe mjete nga buxheti i vitit 2018.

"Arsimi do të jetë një nga pikat e cila nuk do shumë zhagjitje, por duhet vepruar në kohë. Kemi paraparë dhe kemi ndarë mjete për fillimin e rinovimit nëpër shkolla siç janë tualetet dhe kështu me radhë. Jemi duke i bërë analizat për çdo shkollë. Kemi dërguar ekipe në të gjitha shkollat fillore që bëjnë shqyrtim nëpër hapësirat sanitare higjienike në territorin e Komunës së Çairit dhe do ti rinovojmë në një



VISAR GANIU

Kemi paraparë dhe kemi ndarë mjete për fillimin e rinovimit nëpër shkolla siç janë tualetet dhe kështu me radhë. Jemi duke i bërë analizat për çdo shkollë. Kemi dërguar ekipe në të gjitha shkollat fillore që bëjnë shqyrtim nëpër hapësirat sanitare higjienike në territorin e Komunës së Çairit dhe do ti rinovojmë në një kohë të shkurtër

kohë të shkurtër", u shpreh ai.

Ndryshe, në fushatën elektroale, Ganiu premtoi se "Kontrata" e tij parashikon intervenime në dhjetë shkolla fillore dhe në shkollën e mesme "Cvetan Dimov", me një buxhet mbi 380 milionë denarë. Punimet rikonstruktuese përfshijnë rregullimin e fasadave dhe veshjen e tyre me materiale termoizoluese, ndërtimin e rekuizitave sportive në oborre, kangjellat rrethuese, rrugicat për këmbësorë e të tjera në dhjetë shkolla fillore: "Tefejuz", "Vasil Gllavinov", "Ismail Qemali", "7 Marsi", "Imri Elezi", "Jashar Bej", "Kongresi i Manastirit" dhe "Idnina". Ndërsa në shkollën e mesme "Cvetan Dimov", pjesa më e madhe e investimeve i dedikohet ndërtimit të një biblioteke dhe salle leximi, palestres dhe rregullimit të ambienteve të jashtme. (A.Xh)

Fshatrat e Kërçovës 12 orë pa energji elektrike

Kërçovë, 26 shkurt - Stuhia e dëborës që goditi rajonin e Kërçovës shkaktoi një defekt në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, prandaj shumica e fshatrave përreth kanë qenë pa energji elektrike për 12 orë. EVN thonë se po punojnë

për të eliminuar defektin. Banorët e këtyre fshatrave gjithashtu përballen edhe me problemin me furnizimin me ujë të pijshëm, sepse për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, pompat e ujit nuk funksionojnë dhe rezervuarët janë

bosh dhe nuk mund të rimbushet. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike edhe shkollat në mjediset e fshatrave të cilat ngrohen me naftë nuk punojnë. Trashësia e dëborës në qytet momentalisht arrin 15 centimetra, ndërsa mjediset

rurale është dyfish më e madhe. Bora edhe në këto momente vazhdon të bjerë me intensitet të ndryshueshëm. Pas motit me dëborë që i përfshiu rajonin e Kërçovës qarkullimi zhvillohet me vështirësi edhe në kushte dimërore.

Shembet dheu në rrugën rajonale Gostivar-Sërmnovë




Gostivar, 26 shkurt - Komuna e Gostivarit, nëpërmjet ndërmarrjeve publike "Komunalec dhe Parkingje publike dhe gjelbërimi" arrit që me sukses ta menaxhojë shembjen e dheut në segmentin Llakavicë-Sërmnovë, si pjesë e rrugës rajonale Gostivar-Sërmnovë, njofton Komuna e Gostivarit. Deri te shembja e dheut në këtë terren kodrinoro-malor erdhi si pasojë e reshjeve intensive të borës dhe në një pjesë dheu bllokoi rrugën me çka për një periudhë kohore banorët e kësaj ane mbetën të shkëputur nga qyteti. Por, intervenimi i Komunës së Gostivarit ishte i shpejtë dhe falë punës in-

tensive të ekipeve të dy ndërmarrjeve publike, për një kohë të shkurtër rruga u kthye në gjendjen e mëparshme. Rruga Gostivar-Sërmnovë është rrugë rajonale dhe e njëjta menaxhohet nga ndërmarrja publike e nivelit shtetëror "Rrugët e Maqedonisë". Por, Komuna e Gostivarit, ndonëse nuk e ka për obligim, në më shumë raste ka intervenuar për përmirësimin e gjendjes së rrugëve rajonale, me qëllim që qytetarët e Gostivarit të mos pësojnë shkakun e neglizhencës së institucioneve të pushtetit qendror, njofton Shërbimi për informim i Komunës së Gostivarit.



Dilemat e ratifikimit

Jahja KOKA



Nëse hipotetikisht një shtet i huaj bene invazion ushtarak mbi shtetin tonë dhe vendoset në parlament se duhet apo jo ti pergjigjemi sulmit, dihet: Unanimisht të gjitha partitë votojnë për mbrojtje të atdheut. Është kështu nga se kjo është çështje e ashtuquajtur MADHORE KOMBETARE.

Pas 3 vitesh maratonike lidhur me ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi, pas shumë përplasjeve e fëkimeve të plasimit të interesave edhe individuale-partiake, gabimeve drastike procedurale etj., mendoj që kjo qeshtje, me në funde është kualifikuar si qeshtje MADHORE KOMBETARE, për interesin e qytetarëve. Këtë e verteton edhe fakti që të gjithë individët dhe partitë shqiptare, unanimisht po pajtohen për ratifikim. Vendimtare për këtë pajtim mendoj që ishte sygjërimi energjetic dhe persistent i Mikut të SHBA dhe miqëve tjerë perëndimorë.

Bazuar në faktoret e përmendur, do të votojnë pro edhe parlamentarët të cilët vijne nga viset që tangojnë fizikisht dhe emocionalisht në mënyrë familjare dhe personale me pasuritë e tyre kufitare që do të iu mbeten jashtë Kosovës. Me veshterisi të medha, por po e kapërdijne këtë realitet të idhet të krijuar.

Natyrisht, për çështjet tona madhore, parlamentarët serb gjithmonë do të jenë kundër. Kjo është detyra fundamentale e tyre

edhe në parlament dhe kudo. Ata, si edhe historikisht, janë kundërshtarë dhe interesit tonë. Ata do të jenë pro vetëm atëherë kur fitojnë premtime-perfitime shumë të dhembshme për Kosovën.

Perkunder frontit apo taborit që ka arritur pajtueshmëri unanime të përmendur, të tere spek-

trit politik të shqiptarëve, mbetet vetëm VV.

Vetvendosja, sipas mendimit tim, me qenjen e saj karakterizohet si parti konsekuente për interesat madhore kombetare. Është konsekuente për interesat e qytetarëve të Kosovës, sidomos për shtresat e popullsisë së varfër. Ndonese nuk

Argumentet e VV janë të qendrueshme dhe parimore, por mendoj që perkunder kesaj duhet në keto momente ti këne parasysht të pakten keto fakte: a) dëshirën e shumicës dermuese të qytetarëve të Kosovës, b) pajtueshmërinë e arritur të të gjitha partive edhe me parime të kënderta, c) sygjërimet persistente të SHBA dhe miqëve perëndimorë që na mundesojnë dhe kujdestarojnë për lirinë tonë dhe faktin që kjo çështje tanimë është MADHORE KOMBETARE.



kane pasë rastin të qeverisin, por konsiderohen si partia e pa korrupsion. Rrjedhimisht del si partia më progresive dhe më popullore në Kosovë. Ndash nese nuk bëjnë gabime, është vetëm çështje kohe kur do ta marrin timonin e qeverisjes.

Mirpo, ata thue se nuk po i shohin përpelitet dhe me në fund finalizimin e pajtueshmërisë edhe të partive me inetrësia diametralisht të kundërta, janë gropuar në qendrimit e tyre fillestare.

Të theksojnë që argumentet e VV janë të qendrueshme dhe parimore, por mendoj që perkunder kesaj duhet në keto momente ti këne parasysht të pakten keto fakte: a) dëshirën e shumicës dermuese të qytetarëve të Kosovës, b) pajtueshmërinë e arritur të të gjitha partive edhe me parime të kënderta, c) sygjërimet persistente të SHBA dhe miqëve perëndimorë që na mundesojnë dhe kujdestarojnë për lirinë tonë dhe faktin që kjo qeshtje tanimë është MADHORE KOMBETARE. Mendoj që votimi i VV "kundër", krahas Listës Srbska, do ta damtonte imazhin e saj duke humbe elektoratin e qytetarëve të Kosovës.

Sinqerisht mendoj që gjatë votimit të ratifikimit, lista srbska do të mbetet e vetmuar.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 26 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



NE SHQIPTARËT NUK VËMË DOT MEND

Në vent që të vémi të rrëmihim kopshten dhe të mbjellim, na është me udob të bëjmë gati shportat për të mblédhur pémë që s'kanë zen' as rrënjë. Atyrévë cilévë u pëlqén, le t'i vénë politikës pas; kémi shprësë që do të bëjnë punëra të mbédha. Po Shqipëtarët e riñj, në shpirt të cilévë zjen dashuria é mëmédhéut, ditë për ditë po mblidhén rréth é rrotull flamurit tonë, dhe lëftojné né atë luftén é mirë dhe pa gjak nga é cila do të dalë i fortë dhe i math Kombi Shqipëtar.

Faik Konica

Duké parë dhe duké dëgjuar, bota mësojnë ment dhe ndërtohen. Ne Shqipëtarët s'marim dot mësimé; malét të tundén dhe të rrëkéléhén, né nuk këmbéjmë mënyrén tonë. Mbani mirë këtë që po u thom: në njëqint vjët, në vafshin si vémi, do të jémi aqë poshtësa dhe sot. Gréqia u-rrëkëllýé dhe u-shua për jétë: ne, né vent që të maririm mësimé, dhe duké kërkuar shkakét é rrëkëllimit të Gréqisë, të hapim sytë mos na ngjase dhe né

njëshojtjé é përrjetshme, bëjmë ato që humbén grekun. Shqipëria është një vent i mjérë dhe i érrët, pa bukë, pa gjuhë, pa qytétari, pa njéréz të shquar, pa njéréz që njohin të mirén dhe përpqién t'a arrijné. O është detyra é atyré të pakévë Shqipëtaré që kanë në kokë ca fara, dhe në zembërë një cikë dashuri për mëmédhéné? Detyra é tyré është të përpqien të këndohét dhe të shkruhét gjuha shqip, të hapén ca shkolla, të shëndoshét dhe të rritét mendimi kombiar, të çahén dhe udhëra të mira édhé të shumta

nëpër tërë Shqipëri që të ngjallét trégétia dhe bujqësia të cilat janë të ngordhura në dhé tonë. Po këto punëra s'béhén pa vajtjé; duhet, për ti mbaruar, një durim, një mjeshtri qe'mëmédhetarët é vértété s'jané të zotërit t'i kéné. Andaj, ç'bëjnë? Bëjnë një punë shumë më të léhtë: politiké. Të lëshojé Turqinë njëriju dhe të dalé jashtë kufisë, të shkruajé ditë për ditë mémoranda, të këndoñjë gazétat, të lëvdoñjë Shqipëriné përpara të huajvé, é të tjéra, janë lodra për të cilat s'duhét as dituri é madhé as mundim i shumë.

Pa të përpqiét njëriju të ngulénat é ditë, mé çdo mënyrë, mendimin kombiar në tru të Shqipëtarévë ndofta është ca mé rëndë.

Të vésh t'u thuash 'mëmédhetarévë të vértété' éjani të punojmé për gjuhén shqip dhe për mendimin kombiar, do të lodhesh kot: Ata s'duan mundimé, po lodra, duan si Grékërit të vénë nëpër kaféra, dhe, me fjalé për të qëshur, të këmbëjnë kartén e Ballkanikut.

Ashtu bënë Grékërit, andaj u-shuan. Po, siç é thamé, s'jemi të zotërit të héqim mësimé nga vajtjet é

botës. Në vent që të vémi të rrëmihim kopshten dhe të mbjellim, na është me udob të bëjmë gati shportat për të mblédhur pémë që s'kanë zen' as rrënjë. Atyrévë cilévë u pëlqén, le t'i vénë politikës pas; kémi shprësë që do të bëjnë punëra të mbédha. Po Shqipëtarët e riñj, në shpirt të cilévë zjen dashuria é mëmédhéut, ditë për ditë po mblidhén rréth é rrotull flamurit tonë, dhe lëftojné né atë luftén é mirë dhe pa gjak nga é cila do të dalë i fortë dhe i math Kombi Shqipëtar.

ARTI MES HAPËSIRËS JOSHËSE DHE KUJTESËS

Shënime mbi marrëdhënien e veprës së artit me hapësirën/ A duhet t'u flasin veprat e sotme edhe brezave pasardhës, siç na flasin ne sot veprat e artistëve të së shkuarës? Apo ato kanë një mesazh të lidhur ngushtë me këtë kohë dhe nuk është e nevojshme të komunikojné me pasardhësit tanë? Edhe nëse kjo e fundit është e vértetë, përsëri përballemi me nevojën e ruajtjes, qoftë edhe si gjurmë apo relik i së shkuarës, të paktën si memorie historike (jo si kujtesë ontologjike).

Nga Edison ÇERAJ

Çdo ditë e më shumë hapësira po kthehet në mediumin më të rëndësishëm për veprën e artit. Diskutimi se sa bashkëkohor apo i vjetruar është ky apo ai medium, kjo apo ajo formë komunikimi, me sa duket e ka humbur peshën. Shumë artistë sot e konceptojné veprën e tyre të lidhur ngushtë me një hapësirë të caktuar, gjë që do të thotë se nëse vepra zhvendoset diku tjetër, cenohet drejtpërdrejt në thelbin e saj ose nuk është më ajo që ishte në krye të herës.

Nëse këtij fenomenit tipik të ditëve tona do t'i qaseshim nga pikëpamja shoqërore, do vëmë re se kjo prirje shënon një arritje pozitive në drejtim të ndërveprimit dhe shkëmbimit mes njerëzve me identitete dhe prejardhje të ndry-



shme; më së pari mes vetë "kominetit" kulturor dhe më pas edhe mes publikut. Pra, ky fenomen ka bërë që kufijtë të jenë më të brishtë, qoftë kufijtë fizikë, qoftë kufijtë në mendje apo në mënyrën e të menduarit.

Në fakt, duhet të kujtojmë këtu se një vepër arti, sido që të jetë, ka prirjen t'i drejtohet qenies, pavarësisht identiteteve të ndryshme që merr njeriu në kushtet e një kohe apo hapësire të caktuar. Kështu që, është në natyrën e artit që të sjellë

një klimë përbashkuese mes njerëzve, sepse na bën të harrojmë atë çfarë na dallon nga njëri-tjetri dhe të kujtojmë atë çfarë kemi të përbashkët: fatin si qenie në botë.

Nga ana tjetër, nëse këtë qasje e kthejmë nga vetë vepra e artit, mund të themi se kemi të bëjmë me një rrezik për sa i takon jetëgjatësisë apo vazhdimësisë së saj, si nga ana formale (si pasojë) ashtu edhe nga ajo semantike. Natyrisht që forma dhe përbajtja janë të lidhura pazgjydh-

shmërisht me njëra-tjetrën kur bëhet fjalë për një vepër arti. Në këtë rast, fillimisht vihet në pikëpyetje vepra si materie, përmasa fizike e saj, sepse në kushtet e një mjedisi dhe hapësire publike që përballet herë pas herë me ndryshime të caktuara pavarësisht nesh, pa dyshim që as vetë hapësira ku është ekspozuar vepra nuk bën përjashtim.

E thënë ndryshe, këtu hasemi me çështjen e ruajtjes së veprës, me statusin e saj të ndryshëm nga

sendet/objektet e tjera, të cilat shfaqen e zhduken in perpetuum.

Prandaj, kjo varësi e artistëve bashkëkohorë nga hapësira, duhet parë edhe si një rrezik që iu kano set veprave të tyre në lidhje me ruajtjen dhe vazhdimësinë.

A duhet t'u flasin veprat e sotme edhe brezave pasardhës, siç na flasin ne sot veprat e artistëve të së shkuarës? Apo ato kanë një mesazh të lidhur ngushtë me këtë kohë dhe nuk është e nevojshme të komunikojné me pasardhësit tanë? Edhe nëse kjo e fundit është e vértetë, përsëri përballemi me nevojën e ruajtjes, qoftë edhe si gjurmë apo relik i së shkuarës, të paktën si memorie historike (jo si kujtesë ontologjike). Tregu, që ka në qendër të tij konsumin, nga ku rrjedh edhe i ashtuquajtur i konsumerizëm (prodhim sa më i shpejtë, konsum sa më i shpejtë), ka kohë që kërkon ta bëjë pjesë të tij edhe veprën e artit, duke e renditur në kategoritë e veta vetëm si mall ndër mallra.

Por, vepra e artit është një mall që të mbush me mall e prandaj nuk mund të kategorizohet dot ndër mallra pa mall, pa jetë. Hapësira të caktuara janë joshëse për shumë autorë, por mendoj se më joshëse duhet të jetë kujtesa.

Përse vallë kërkojmë me kaq këmbëngulje të përkujtojmë veten? Madje e bëjmë këtë edhe në gjallje. Dëshirojmë ta theksojmë ekzistencën tonë, njëlloj siç pshurrit qentë mbi fikësit e zjarrit. I vendosim në vend të dukshëm fotografitë tona në korniza, diplomat tona në pergamenë, filxhanët e veshur në argjend; vendosim monogramet në të linjtat tona, gdhendim emrat tanë në pemë, i shkarravisim në muret e banjave publike. Gjithnjë e njëjta shtysë. Çfarë shpresojmë të marrim në këmbim? Miratim, zili, respekt? Apo thjesht vëmendje, e cilitdo lloj qoftë ajo? Më së paku duam një dëshmitar. Nuk e durojmë dot idenë që më në fund zërat tanë do të heshtin, si një radio që po i bie bateria...Vdekja e mistershme e gruas së re, Laura Çejis prej vitit 1945, ndoshta dhe vetëvrasje ka mbajtur fijen e së shkuarës edhe pas 50 vjetësh duke u kujtuar nga të mbijetuarit, familja. Raporti i letërsisë me të shkuarën, historinë dhe kujtesën gjithnjë është një moment intuitiv që e kthen labirintin imagjnativ të shkrimtarit për të ushtruar mendjen krijuese. Romani që mban këto fije kujtimesh rreth të mistershmes, dhe çfarë ndjek një histori të gjatë rrëfimi, është "Vrasësi i verbër" e autores Margaret Atwood, me të cilin ka fituar në vitin 2000 çmimin "Man Booker", pasuar edhe me të tjerë. Ky botim vjen në shqip nga botimet Pegi, përkthyer nga Agim Doksani, një roman që nuk është vetëm saga e një familjeje të pasur, por edhe saga e fajeve dhe përgjegjësi që mblidhen mbi njëra-tjetrën, si të ishin kukulla të vogla të verbra, që na lënë gjithmonë me pyetjen: "Po individ, ç'rol luan këtu?".

"Në prag të panairit, është e qartë që ky është një nga titujt më të mirë që Botime Pegi do të ketë sivjet. Në këtë roman do të gjeni luftën për

MARGARET ATWOOD: MJESHTRË E TRILLIMIT, PËR SAGËN E FAJEVE DHE PËRGJEGJËSIVE

"Vrasësi i Verbër", nga Margaret Atwood, përkthyer nga Agim Doksani. Ky roman është fituesi i çmimit Man Booker Prize në vitin 2000 dhe disa të tjerëve. Në të rrëfëhet saga e një familjeje të pasur kanadeze, e kryesisht peripecitë e dy motrave.

para e pushtet, dashurinë, xhelozinë dhe dinakërinë, si dhe një prej personazheve më të ndërlikuara të historisë së letërsisë: një heroinë që ngre pyetje fundamentale mbi përgjegjësitë, fajet dhe keqardhjen që mund të na shoqërojë një jetë të tërë", thotë botuesja e Pegit, Loreta Berhani.

Është historia e jashtëzakonshme e motrave Çejis dhe sekreteve të tyre. Romani nis me vdekjen e mistershme, e një gruaje të re, Laura Çejis, në vitin 1945. Pas më se pesëdhjetë vjetësh, Irisi, motra që mbijetoi, kujton vdekjen misterioze të saj, fëmijërinë dhe dramën e njëpansnjëshme që kanë populluar historinë e familjes së tyre të pasur e të

veçantë. Të gërshtuara me këto kujtime, të cilat Irisi vendos t'i shkruajë, gjenden kapitujt e romanit të Laurës, "Vrasësi i verbër", i cili u botua pas vdekjes së saj dhe njëherësh skandalizoi botën, por e bëri edhe atë të famshme. Në këtë roman, dy dashnorë të fshehtë zbavitin njëri-tjetrin me historinë e një vrasësi të verbër në një planet të largët. Këto rrëfime brenda rrëfimit, me shtresa të shumta, hap pas hapi, hedhin dritë mbi sekretet që i janë fanitur shpesh familjes Çejis. Në mbyllje të romanit, ato do të bëhen bashkë në një fund befasues. I vendosur në sfondin panoramik të historisë së shekullit XX, ky roman është një rrë-

fim epik i kujtimeve, intrigës dhe tradhtisë. Përveç Man Booker Prize, ky roman ka fituar edhe çmimin Hammet, si dhe ka qenë ndër veprat e nominuara për çmimet Governor General's Award, Orange Prize for Fiction dhe International Dublin Award. Revista Time e ka shpallur romanin më të mirë të vitit 2000 dhe e ka përfshirë në listën e 100 romaneve më të mira të shkruara në Anglisht, që prej vitit 1923. "I shkëlqyer... i pasur... Atwood-i është poete... dhe mjeshtre e trillimit; pothuajse asnjë fjali në prozën e saj të shpejtë, të thatë e megjithatë të etur, nuk dësh-ton së bëri një punë të dobishme, duke kompletuar kështu një tablo

të gjerë", ka shkruar shkrimtari John Updike, në The New Yorker; ndërsa Sunday Times, shkruan: "Atwood nuk ka shkruar kurrë me kaq afsh dhe zhdërvjelltësi... një roman kaq i larmishëm që do të ngjallë interesin e të gjithëve... Brillant!". Margaret Eleanor Atwood (Ottawa, 18 nëntor 1939) është poete, shkrimtare dhe ambientaliste kanadeze. Ajo ka fituar çmimin Arthur C. Clarke, çmimin e Princit të Asturias për Letërsinë, çmimin prestigjioz Booker Prize (në të cilin ka qenë finaliste për pesë herë) pikërisht me "Vrasësi i verbër" dhe dy herë çmimin e Guvernatorit të Përgjithshëm, i cili jepet nga kryeministri kanadez.

NOVELA BOTËRORE

kioskat e leximit janë botimet "Poeteka", që këtë verë sjellin dy botime me Novela botërore nga autorët më të rëndësishëm botërorë, të përkthyer nga Arjan dhe Silvana Leka.

Autorët janë nga: Miguel de Cervantes, Charles Dickens, Anton Chekhov, Rudyard Kipling, Selma Lagerlof dhe Frederik Mistral, Mark Twain, Leo Tolstoi, Jack London, Alphonse Daudet, Gustaf Flaubert. Mes kësaj përzgjedhjeje autoriale të prozës së shkurtër, tre prej autorëve janë fitues të çmimit Nobel. Nga Anton Chekhov vjen historia e Volodjas dhe Çeçevicit, duke na futur në botën e peripecive të dy adoleshentëve, që duan të arratisen nga jeta e mërzitshme që ata bëjnë në qytezën e tyre të vogël dhe të mbyllur apo nga familjarët e tyre që u japin vetëm këshilla? Fantazi e Chekhov krijon atmosferën e personazheve që duan t'i ngajmë, për të njëjtin fat. Miguel de Cervantes, me gjuhën e fabulës, sjell dialogun mes dy qenve: Berganax


dhe Shipionit. Përmes rrëfimit të jetës së tyre, jeta e njerëzve satirizohet aq shumë sa kuptojmë se sa e pandryshueshme është natyra njerëzore dhe sa të pandreqshme bëhen marrëdhëniet mes nesh kur futen më mes egoizmi dhe pasionet e verbra. Charles Dickens, ky mjeshtër i ndërimit të karaktereve dhe situatave, në prozën e tij të fortë dhe të drejtpërdrejtë, me fjali që nuk të shlyhen lehtë nga kujtesa dhe që ke dëshirë t'i përdorësh edhe gjatë bisedave në shoqëri, rrëfen historinë e një djali të cilit i ati, një njeri i njohur, i tha se nuk po i linte pasuri tjetër, veç emrit të mirë. Ndër dilemat që na lë Dickens për të menduar: A është gjithmonë i mjaftueshëm vetëm emri i mirë? A është e mjaftueshme trashëgimia që na lënë të tjerët, në një jetë me sfida gjithmonë e më të forta? Rudyard Kipling përzien fantazinë e harlisur dhe humorin shpërthyes, kur rrëfen versionin e tij lidhur me teorinë e evolucionit të Darvinit dhe Zanafillën e Botës. E dimë se si u krijua bota, qiell-

li dhe toka, por a e dimë si janë krijuar edhe kafshët që duam aq shumë, që i mbajmë në shtëpi dhe që kënaqemi kur nga dokumentarët në ekran mësojmë kureshti nga jeta e tyre? Kipling rrëfen shumë këndshëm historinë sesi hunda e padobishme e një elefanti të vogël plot kërshtëri, arrin të bëhet një feçkë e gjatë, aq e gjatë sa me të mund të freskohet në lumë dhe të lëshojë tinguj si trombat luftarake. Mark Twain na rrëmben në botën imagjinare dhe plot humor, përmes historisë së jashtëzakonshme të Kapiten Shtrengatës (Captain Stormfield), i cili gjatë udhëtimit të tij ndërplanetar kozmik dhe komik njëherazi, dëshiron të zbulojë nëse të famshmit në Tokë janë po aq të famshëm edhe në qiell, nëse ekziston drejtësia edhe në qiell apo ky është një koncept qesharak. Njerëz të panjohur dhe me shumë talentet, si një këpucar i cili "ka shpirtin e një poeti, por që do t'i duhet të bëjë më këpucë, siç bëri në Tokë, zë vendin e nderit në qiell dhe përfillet më

shumë se William Shakespeare, Homeri, Buda, Danieli, Adami apo Jeremia. Tolstoi me dhimbje dhe emocion, sjell pamje të Rusisë dhe njerëzve të saj, përmes historisë së Poliushkas, atij që premtonte se do ta mbajë fjalën, se nuk do të dehet më, nuk do të bëhet qesharak dhe se do të përmbushë detyrimet e tij.

Jack London, njohësi i detit dhe i fshehtave të lundrimeve në ishuj të largët, na çon në një botë tjetër, larg qytetërimit, aty ku shpesh na çojnë ëndrrat dhe aventurat...

Historia plot fantazi e një proverbial nga Provansa franceze është stilizuar në një histori gazmore të shkruar nga Alphonse Daudet. Dhe mjeshtëria e Gustave Flaubert që ka magjepsur breza të tërë lexuesish, duke na paraqitur edhe këtë herë pëshpërmat dhe zërat e një bote misterioze përmes alegorisë së jetës së Julianit, njeriut të cilit fati i kishte parashikuar që në lindje se do të bënte gjëra të mëdha, por edhe të tmerrshme njëkohësisht, si: vrasja, incesti, dashuria e zjarrit. Dy Novelat botërore kanë një sintezë njohjeje së paku për të kujtuar disa klasikë të harruar mbi tavolina leximi.



Për një lexues shqiptar që përumbet në një treg që nuk ekziston asnjë anketim sociologjik mbi natyrën e librave që lexojnë, sidomos për të rinjtë, letërsia klasike është një mur i lartë që e ka mundimin pikërisht në të kuptuarit, mbi një ndjeshmëri relative. Panairët e librave shpesh më shumë se promovojnë apo orientojnë idetë kalonjë nga bumerangu i shitjeve duke ngritur një barriera kaotike kur fjala vjen për "shopping" të librave. Një lehtësi mbi

HERMAN HESE


“PRINCI I REPORTAZHIT”

RYSZARD KAPUSCINSKY

Nga fundi i jetës së tij, “Princi i reportazhit” Ryszard Kapuscinsky u përpoq t’u përgjigjej pyetjeve me të cilat ishte përballur gjatë udhëtimeve të tij, duke u mbështetur dhe kombinuar kërkimin e gazetarit me nuhatjen e romancierit për të dalluar tendencat e epokës së tij. Njohja e “Identitetit” e përfshiu të gjithin, veçanërisht përkufizimi i “Tjetrit”. Për këtë, në vitet 2003-2004 ai mbajti disa leksione mbi këtë temë në Krakov dhe Vjenë, dy qytete në zemër të Europës Qendrore, vende të përfshira në dramën e madhe të urretjes, krijimit dhe shkatërrimit në historinë e Europës në shekujt e 19-të dhe 20-të. Këto leksione vijjnë të përmbledhura në librin “Tjetri”, të sapobotuar edhe në shqip, me përkthim të Astrit Beqiraj, botimet “Papyrus”, ndërsa është promovuar në mjediset e librarisë Friend’s Books House.

Identiteti vazhdon të jetë një prej çështjeve më të rëndësishme në këtë 30-vjeçar, sa çka qenë në shekullin e 20-të, duke pasur në shtyllë nevojat kryesore njerëzore.

Kapuscinski e njeh këtë realitet. “Çdo person që takojmë përgjatë rrugës dhe nëpër botë është në një mënyrë të dyfishtë”, thotë ai. Së pari, ka “një person si ne të tjerët”, i cili ka “gëzimet dhe pikëllimet e tij, që nuk dëshiron të jetë i urit, ose ...të ketë të ftohtë, të ndiejë dhimbje si vuajtje dhe të ketë pasuri të kënaqshme dhe përmbushëse”. Por është personi i dytë, “i cili përputhet me të parin”. Ai është “bartës i karakteristikave racore dhe të një kulture besimi dhe bindjeje”. Këto dy entitete bashkekzistojnë dhe bashkëveprojnë pa ndërprerje, thotë Kapuscinsky dhe sipas tij kushdo që ka udhëtuar nëpër botën tonë gjoja të “rrafshuar” në vitet e fundit, mund ta



konfirmojë këtë. Pak mund të mohojnë tërheqjen emocionale të fisit, kombit, komunitetit gjuhësor ose dallimin e popujve, racave, gjuhëve, kuzhinave, traditave dhe historive.

Këto janë leksione të vlerësuara të urta, por edhe të thella të Kapuscinsky që mbështetet shumë në Emmanuel Lévinas, filozof hebre-francez i cili këmbënguli se ne jemi të definuar si individë nga qëndrimi ynë ndaj “Tjetrit”. Por ai gjithashtu citon udhëtarin

zviceran, mendimtarin dhe shkencëtarin Albrecht von Haller, Goethe, Upanishadët, Montesquieu, Conrad dhe shumë të tjerë. Ai mbështetet thellë në traditat polake dhe sekulare filozofike dhe letrare, duke na kujtuar origjinën e tij. Kritik i Eurocentrimit, Kapuscinski komenton me vëmendje se “të gjitha qytetërimet kanë një tendencë drejt narcizmit dhe sa më i fortë të jetë qytetërimi aq më të qartë e shfaq këtë tendencë”.

Leksioni i fundit është “Për multikultu-

Nga fundi i jetës së tij, “Princi i reportazhit” Ryszard Kapuscinsky u përpoq t’u përgjigjej pyetjeve me të cilat ishte përballur gjatë udhëtimeve të tij, duke u mbështetur dhe kombinuar kërkimin e gazetarit me nuhatjen e romancierit për të dalluar tendencat e epokës së tij. Njohja e “Identitetit” e përfshiu të gjithin, veçanërisht përkufizimi i “Tjetrit”, duke botuar një libër me disa leksione, të cilat janë sjellë edhe në shqip nga Astrit Beqiraj

ralizmin”. Kapuscinsky e dorëzoi atë më pak se tre vjet para se të vdiste në vitin 2007. Ky vlerësohet një diskutim i habitshëm i freskët dhe perceptues i asaj që sot do të thotë identitet. Duke nxjerrë në pah një histori të shpejtë të vizioneve evropiane të pjesës tjetër të botës, Kapuscinski thekson se “ideja e barazisë me të tjerët i ndodhi vetëm mendjes njerëzore shumë vonë, shumë mijëra vjet pasi njeriu la gjurmët e pranisë së tij në Tokë”. Në shekullin e 21-të, thotë ai, ne do të hasim “Tjetrin” në mënyra dhe me një frekuencë që kurrë nuk do ishte imagjinuar.

Në këtë libër të shkurtër, të thjeshtë, mbushur me mençuri Kapuscinsky përipiqet të formulojë se çdo të thotë të jesh European, jo european, të jesh i pushtuar, të jesh pushuesi, të kesh apo të imponosh një identitet. Në fillim të librit, ai citon një aksiomë të antropologut polak, Bronislaw Malinowski: “Që të mund të gjykojmë për diçka, duhet të jesh atje”. Kjo thënie duhet të qëndrojë varur mbi dyert e çdo dhome lajmesh, dhe fakulteti gazetarie. Kapuscinsky pati shkuar “atje”, kudo. Si gjykatës ai është i drejtë, human dhe i matur – dhe aq i rëndësishëm tani sa ç’ishte dhe do të jetë.

CILAT JANË 6 AVANTAZHET QË BUKINIST.AL I OFRON LEXUESIT

Gjatë vendosjes së fillimit të projektit janë bërë kërkime për operatorët e tjerë në treg, por eksperiencia e suksesshme me platformat e tjera dhe stafi prej 50 personash i cili punon edhe për Bukinist, kanë bërë që gjatë një viti që projekti të ecë me hapa shumë të shpejtë, me një vizion shumë të madh dhe sukses në rritje.

Ja 8 avantazhet ekçasaj shtçpuie botuese digjitale:

1. Librat e rinj publikohen një javë përpara se të dalin, kështu jo vetëm që lexuesit informohen në kohë por kanë mundësi ta rezervojnë përpara se të dalin.

2. Libri dërgohet në të gjithë Shqipërinë, kudo që të jetë lexuesi, pranë nuk ka nevojë për të harxhuar kohën duke shkuar tek libri.

3. Ka ndërtuar një komunitet lexuesish, të cilët mund të lenë përshtypjet dhe më shumë informacion tek libri, në mënyrë që lexuesit e tjerë ta kenë shumë të thjeshtë zgjedhjen e tyre.

4. Libri në shqip dërgohet në të gjithë botën, edhe me DHL nëse e dëshironi brenda 2-3 ditësh.

5. Lexuesi ka shumë llojshmëri më të madhe të zgjedhjeve pa dalë nga shtëpia.

6. Lexuesit kanë mundësinë të përfitojnë nga oferta të ndryshme që bëhen vazhdimisht për librat.

Gjatë vendosjes së fillimit të projektit janë bërë kërkime për operatorët e tjerë në treg, por eksperiencia e


suksesshme me platformat e tjera dhe stafi prej 50 personash i cili punon edhe për Bukinist, kanë bërë që gjatë një viti që projekti të ecë me hapa shumë të shpejtë, me një vizion shumë të madh dhe sukses në rritje.

Lindur më 19. 7. 1954 në Sllupçan të Kumanovës. Filloren kryen në Opajë, të mesmen në Kumanovë, kurse studimet, gjuhë dhe letërsi shqipe në Shkup. Studimet post-diplomike (dy vite) kryen në Prishtinë, kurse magistraturën e mbron më 1983. Doktoraturën me titull "Rrëfimi në romanin monologjik shqiptar" e nis në Prishtinë dhe e mbron në Shkup, më 1994. Duke filluar nga viti 1977, punon në gazetën Flaka si përkthyes, ndërkaq duke filluar nga nëntori i vitit 1979, punon në katedrën e Albanologjisë në Shkup.

Profesor Nehas SOPAJ e ka filluar aktivitetin e tij krijues që në fëmijëri. Në shkollën e mesme ai zë vendin e parë në për disa konkurse letrare me çka shpejt bie në sy duke u afirmuar në përmasa më të gjera duke u përkthyer dhe futur në lekturë shkollore shumë i ri. Si maturant më 1973, ai boton dy vëllime poetike: Këngët e blerta në Shkup dhe e Algje, në Prishtinë. Vlen të shënohet libri Të fala prej hënës, një kërcim surrealit, një risi që u shqua sepse polarizoi kritikën letrare të kohës. N. Sopaj më vonë shkruajti prozë të shkurtër, tregime e novela, për të vazhduar më tutje, edhe me romanin dhe dramën.

Paralelisht me letërsinë e pastër, ai heret fillon të merret edhe me kritike letrare. Nga librat më të dalluara të autorit, sot mund të konsiderohen dy zgjedhjet nga gjithë opusi poetik me titull Alga e dalë nga deti (2001) dhe Larg (2009), nga të cilat duhet të theksohet se e para u fut në projektin shtetëror, duke u përkthyer në gjashtë gjuhë të botës, prej nga deri tani u botuan anglisht dhe maqedonisht, dy vëllimet me tregime Letër Lirijes (1987) dhe Në fund të Akeronit (1993), dy romanet – Fluturimi mbi Sllupçan (1997, 2007) dhe Unaza e humbur (2003). Nga kritika letrare dhe eseistika e autorit Nehas Sopaj, duhen shquar veprat: Paralelet letrare, me dy studimet – Rrëfimi në romanin shqiptar dhe Purolirika shqipe (1998), Individualitete letrare 1 – Beqir Musliu (2007) dhe Individualitete letrare 2 – Teki Dërvishi (2013). Si antologjist, N. Sopaj është autor i veprës Antologjia e poezisë së pastër shqipe (2002) dhe tekstit universitar Letërsia për fëmijë (2000, 2007).

Përveç poezisë dhe Prozës, ai ka lëvruar edhe perkthimin, atij i dedikohen një numër përkthimesh nga kroatishja dhe maqedonishtja në shqip si "Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë", përkthim nga kroatishja, Rilindja, Prishtinë 1985." Antologjia e poezisë erotike maqedonase", përkthim nga maqedonishtja, Flaka, Shkup, 1985. 1987, "Përralla për peshkun dhe peshkatarin", përkthim nga maqedonishtja në shqip, Mislla, 1988. fq.52. 12. "Lulet e para", përkthim nga maqedonishtja, Makedonska kniga, 1988, fq. 120



NEHAS SOPAJ

Për Nënë!

Vetmia

Njëzet minuta para se ta jepte frymën e fundit,
Nana shikoi orën në mur
vetë Nana,
vetë.
Një jetë të tërë, vetë.
Vetë vetmia,
vetë zjarri i vatrës sonë.

Së pari e lëshoi një pikë loti,
pastaj shkoi e u bë fletë duhani.

Pastaj,
me sy të lëmekur,
u shndërrua në letër të bardhë
të cilën e nxijmë ne të tjerët, përgjithmonë.

Tani unë në tërë pjesën time të jetës -
thahem, terem, zvogëlohem,
bëhem mi,
e Nana vetë,
vetë
Nana,
shndërrohet në kuptimin

të cilit akoma s'ia kemi gjetur emrin e vërtetë

Nana ose ora e ndalur

Pak para se të vdiste, Nana shikoi orën në mur,
priti e priti
kur do të vdiste,
por të gjithë zogitë e botës
ranë përtokë.

Toka u bë hi,
e era - Hera
ose nusja pa duvak,
që desh t'ia mbathte përtej kohës,
mejt...

Unë, i përzura me duar të gjitha yjet nga qielli.
Nana shikoi orën në mur,
muri u lëkund:

"Mbahu Nano!"

Dy vite më vonë

Nanë, kur ti shkove të bëhesh tokë
unë kafshë u bëra,
me ujku që po më hante dalëngadalë.
Nanë, kur ti një dite shkove të bëhesh qiell
unë lotë u bëra,
një pikëz uji që dielli e pinte ngadalë e nuk
sosej.

O kur ti, Nana ime, një dite shkove të bëhesh
muzikë,
muzikë e të gjitha sferave të mia,
për mua perënduan - dielli, hëna dhe gjitha
yjet.

Kujtoni Hyun kur ju tha: prej toke ju bëmë
e në tokë do t'ju kthejmë një ditë!
Lumë ai që do të rilindë!

Katër vite më vonë

Katër vite pas vdekjes, në kopshtin tim,
prej parajse erdh Nana.
Vetë.

Këmbë.
Me flokë të lidhura gërshet.

Qe shndërruar në letër të bardhë.
E kishin nxirë të gjithë kalemxhinjtë tanë.

E unë,
në pjesën time të ëndrrës,
që akoma vazhdoj të thahem, të terem, të
zvogëlohem,
të bëhem mi,
para hirit të saj, pa zë, zura të qaj e të
shkrehem.
Por ata, vëllezërit e mi siamezë,
kufomat e gjalla,
pa shikoji si trashen e majmen. Në çdo kohë.
Shih si kolmen.

Kopshtit tim po i bie erë kutërbimesh,
kalbjesh.

Nana kalon kopshtit me pemë

Edhe pse ka vite që ka vdekur,
Nana kalon kopshtit me pemë, karshi meje,
unë e ndal frymën dhe s'pipëtim
duke ia kërkuar
fytyrën;

ajo është një rrufe me flokë lidhura gërshet
dhe unë s'guxoj t'ia kërkoj sytë; s'guxoj sepse
sytë e të vdekurit mund ta ngrijnë në vend të
gjallin.

Këta sy,
sy mamuthi që hedhin zjarr,
uranium nga rruazat e nëntokës,
kërpudhë atomike,

po pra, këta sy janë mu ajo vetë!
Ajo s'është më ndër të gjallët, por në vend të
tyre,
do rruaza të vogla e të zeza, si rruhi i hidhët,
ndanë një kaçubeje, sytë e saj gëlojnë

mëllagave si glaca zogjsh!

E unë, e unë,
në herbarium shoh një kanjushë si fluturon
me zanat hemafrodite të Sambapatisë
së Santanas,
hardhisë të cilës
i kanë rënë rushtë përtokë
me fletat e gjelbërta e të skuqura flakë,
vjeshtës që po ia ha breshka
shermenin e fundit.

Ajo,
Nana jonë,
një ditë do të na çlirojë nga ëndrrat...

Një ditë
ajo do të na gjejë
në një fletë fluturë, në këtë kerubin,
në këtë herbarium,
i cili rri mbyllur
në bodrum
me merimanga.

E po ç'të bësh Idriz Seferi

Para se të nisem kah vetja dhe njerëzit,
do të bie, të fle sonte, pa sytë e mi.
E po, ç'të bësh Idriz Seferi, ç'të bësh.
Më thuaq si t'ia nxjerr një fjalë Karadakut, më
thuaq
si të filloj të flas me gjakun tim. Më thuaq.
Ky pyll i bletë sonte po nisat
deri te zemra ime. Unë të njoh, Idriz Seferi
Të njoh. Ty dhe gjithë zemrat e skifterëve, ju
njoh.

E po, ç'të bësh Idriz Seferi, ç'të bësh.
Kështu e ka ky vend me lule. Kështu e ka
kjo erë plot shi. Disa vdesin për liri, Idriz
Seferi,
e disa shtrijnë duart e tyre zaptuese në botë.
E po, ç'të bësh Idriz Seferi, ç'të bësh.
Para gjashtëdhjetë vjetësh ti puthe
çdo pëllëmbë të Karadakut dhe Kosovës, Idriz
Seferi.
Ti kishe vetëm një trup dhe një ëndërr
ç'të bësh, në ëndrën tënde farkohej liria,
dhe rritej Karadaku i kuq me një diell të
lulëzuar.

Dhe, një hënë prej purpuri. Ç'të bësh.
E po, ç'të bësh Idriz Seferi, ç'të bësh.
Më trego si të flas me gjakun tim të bleruar,
dhe gurin. Më trego, Idriz Seferi, më trego.
Si të flas me heshtjen tënde të bekuar.
Në gur dhe në ujë, çelin jorgovanet,
kurse në botë lindin shumë flaka të kuqe
dhe lule të flakave. Do të këndoje sonte, Idriz
Seferi,
para se të nisem kah vetja dhe njerëzit.
E po, ç'të bësh Idriz Seferi, ç'të bësh.
(1975)

Koha, e martë 27 shkurt, 2018



Dashuria për një femër që e shtyri studentin të tentojë ta vrasë presidentin amerikan


Vetëm dy muaj pasi kishte marrë postin e shefit të shtetit, presidenti Reagan ishte cak i atentatit. Më 30 mars 1981 në Uashington ndaj tij shtiu me armë zjarri John Hinckley Jr, një student i pasionuar pas aktores Jodie Foster dhe tentoi që ta impresionojë me vrasje. Në fakt, studentin me çrregullime mentale ishte tërësisht i dhënë pas Foster, pasi kishte shikuar filmin 'Taksisti'. Nisi t'i dërgojë letra dashurie dhe këngë në kampus, madje e thërriste edhe në telefon. Foster e kishte refuzuar dhe Hinckley i krisi ideja e madhe.

Studenti i dështuar John Hinckley Jr. (25) kishte tentuar të vrasë presidentin amerikan Ronald Reagan në vitin 1981, por plumbi i atentatorit kaloi për vetëm disa centimetra larg zemrës së tij

Në këtë mënyrë, ai vendosi të bëjë atentat ndaj Reagan, në mënyrë që të bëhet "figurë historike". Hinckley priti që Reagan të dilte nga hoteli Hilton në Uashington. Kur presidenti me truproja dhe të tjerët u nis drejt limuzinës, Hinckley arriti deri te presidenti dhe shtiu disa herë. Me këtë rast u qëllua Reagan, asistenti i tij James Brady dhe dy persona tjerë. Plumbi i atentatorit kaloi vetëm disa centimetra larg zemrës së presidentit dhe i

shkaktoi gjakderdhje të brendshme. Reagan fatmirësisht mbeti gjallë dhe pas rikuperimit tha se e fal Hinckleyn. Për shkak të problemeve mentale, Hinckley u lirua nga akuza për vrasje dhe pas shërimit të gjatë psikiatrik u kthye në shoqëri dhe sot jeton në shtëpi me nënën e tij. Në spitalin shtetëror në Uashington qëndroi për 35 vjet. John Hinckley Jr sot ka 62 vjeç dhe nuk është i rrezikshëm për shoqërinë.

Ai duhet t'iu përmbahet kushteve: Nuk guxon të flasë për media, duhet të punojë tri ditë në javë, nuk guxon të largohet më shumë se 48 kilometra nga shtëpia e nënës së tij dhe 80 km nëse është i shoqëruar nga dy persona, dhe dy herë në muaj duhet të vizitohet psikiatrin. Ronald Reagan ndërroi jetë në vitin 2004, në moshën 93-vjeçare.



BUNKERI sekret i Titos në Bosnjë që kushtoi

4.6 miliardë dollarë

Ndërtimi i bunkerit zgjati nga 1953 deri në 1979 dhe kushtoi 4.6 miliardë dollarë. Që nga fillimi i ndërtimit, objekti është fshehur nga natyra



Pak më shumë se tri dekada në malin Zlatar në afërsi Konjic, në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte ndërtuar një strehim dhe për objektin ishin në dijeni vetëm katër komandantë zyrtarë. Punëtorët që ndihmuan në ndërtimin e bunkerit nuk lejohet të nënshkruajnë marrëveshjen për të heshtur. Ndërtimi i bunkerit zgjati nga 1953 deri në 1979 dhe kushtoi 4.6 miliardë dollarë. Që nga fillimi i ndërtimit, objekti është fshehur nga natyra. Bunkeri përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë e maskuar është e dukshme nga jashtë, si dhe rezidenca, objekti për sigurimin më të ngushtë të ish-presidentit të RSFJ-së Josip Broz Tito dhe objekti për mbështetje teknike.



Kur kalon në korridorin e objektit të parë, hapet një derë metalike prej 1.28 metrash, pas së cilës tuneli të çon në zemër të një strehimi atomik në një thellësi prej 280 metrash. Tunnelt janë të lidhura ndërmjet seksionit të maskuar dhe strehës atomike që mund të përballojnë një sulm bërthamor prej 20 kilotonësh. Pjesa e fundit e objektit është në formë të kalorësisë dhe ka 12 blloqe. Brenda saj janë sistemet e mbrojtjes, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistemi i mbrojtjes bërthamore dhe klimatizimi. Bunkeri ka një dalje alternative, e cila nuk është në hartë dhe shkon 170 metra lart mbi objektin. Më shumë se njëqind dhoma gjumi u vendosën në një total prej 6854 metra katrorë, ku 350 persona nga majat më të larta politike dhe kombëtare të RSFJ mund të flinin në rast të një sulmi bërthamor. Ata mund të qëndronin për gjashtë muaj pa ndonjë kontakt me botën e jashtme. Përveç një sërë dhomash, rezidenca luksoze e Titos me pesë dhoma gjithashtu zë një vend të rëndësishëm.

Objekti është sot një muze që i përket Ministrisë së Mbrojtjes së Bosnjë e Hercegovinës, dhe ruhet nga pesë ushtarë dhe aty mbahen ngjarje kulturore.





Strasbourg, sulmohet konsullata e Kosovës

Gjatë fundjavës është sulmuar Konsullata e Përgjithshme në Strasbourg ku edhe është vjedhur flamuri. Këtë e ka bërë të ditur Edon Cana, konsull në ambasadën e Kosovës në Francë duke shtuar se autoritetet franceze shpejt do ta sjellin para drejtësisë sulmuesin.

"Gjatë vikendit është sulmuar Konsullata e Përgjithshme në Strasbourg dhe

është vjedhur Flamuri i Republikës dhe është shkatërruar Stema e Shtetit. Simbolet e Shtetit të Kosovës i pengojnë armiqve tanë!

Duke i falënderuar autoritetet Franceze për mbështetjen e tyre, jemi të bindur se mbas forenzikës së bërë, sulmuesit shpejt do të gjinden", ka shkruar Cana në Facebook.

Rama ka realizuar një takim me Juncker, ndërsa në konferencën për mediat u përqendruan në procesin e reformave në Shqipëri, perspektivën evropiane të Shqipërisë, si dhe bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në kuadër të turneut të vizitave në vendet e Ballkanit, presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, ka vizituar Shqipërinë, ku në një konferencë për mediat me kryeministrin e vendit, Edi Rama, theksoi se për Bashkimin Evropian vendet e Ballkanit Perëndimor janë vende aleate dhe partnerë. Rama ka realizuar një takim me Juncker, i cili shoqërohet gjatë vizitës nga komisioneri i BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit Hahn, Johannes Hahn, ndërsa në konferencën për mediat u përqendruan në procesin e reformave në Shqipëri në disa fusha, perspektivën evropiane të Shqipërisë, si dhe bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Për ne, Ballkani Perëndimor dhe Shqipëria veçanërisht janë vende mike, aleate dhe partnerë, që kanë një perspektivë evropiane. Konstatoj me kënaqësi që Shqipëria nuk pushon së akumuluar progreset sepse ka ndërmarrë reforma strukturore në shumë fusha që janë impresionuese dhe këto progreset janë mbre-



BALLKANI KA PERSPEKTIVË EVROPIANE

sëlënëse nëse vazhdojnë në këtë rrugë reformat. Kjo do t'i lejojë Shqipërisë që KE të rekomandojë hapjen e negociatave. Inkurajoj Shqipërinë të vazhdojë reformat e rëndësishme që janë ndërmarrë sidomos në luftën kundër krimit dhe organizimit të gjyqësorit. Ne do të jemi përkrah Shqipërisë për ta ndihmuar të përgatitet për anëtarësimin (në BE). Të gjitha problemet me vendet kufitare duhet të jenë të zgjidhura deri në datën e anëtarësimit", tha Juncker. Ai ka shtuar se BE mbështet Shqipërinë në të gjitha përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve me vendet e Ballkanit, ndërsa ka thek-

suar se "vendi i natyrshëm i Shqipërisë është në Bashkimin Evropian".

Rama theksoi se ka informuar kreun e KE-së, Juncker, për ecurinë e reformave dhe vendosmërinë Shqipërisë, sipas tij të për të vijuar të jetë nga njëra anë në një proces intensiv përafrimi me BE-në dhe nga ana tjetër një aktor konstruktiv për nxitjen e bashkëpunimit rajonal. "Ka hyrë në proces operacioni 'forca e ligjit'. Ka hyrë në proces reforma që synon lehtësimin të burokracisë me qytetarët, me efekt luftën kundër korrupsionit. Ka hyrë gjithashtu në proces një transformim rrënjësor në marrëdhëniet e

drejtësisë me qytetarët. Vendosmëria jonë mbetet e palëkundur sepse reformat e integritimit janë të domosdoshme sepse i kërkon Shqipëria dhe është borxhi që i kemi gjeneratës tjetër. Ky është një proces unik i pazëvendësueshëm për funksionimin e institucioneve demokratike", tha Rama. Sipas Ramës, integrimi në Bashkimin Evropian është një përpjekje për të ndërtuar Shqipërinë evropiane, duke shtuar se hapja e negociatave (me BE-në) përbën sipas tij hapjen e një kapitulli të ri përpjekjesh, në rrugën e reformave për anëtarësimin e plotë të vendit në BE.

S'ka karotë të BE-së që Serbinë e detyron të heqë dorë nga Kosova

Ministri serb i Punëve të Jashtme Ivica Dačić ka thënë se nuk ka karotë evropiane nga BE për të cilën Serbia me vetë dëshirë do të hiqte dorë nga Kosova. "Është pafytyrësi që qarqe në Bruksel të presin nga ne harakiri historik, ndërsa ata vetë brenda BE-së nuk kanë qëndrim unik kur bëhet fjalë për çështjen e Kosovës", ka thënë Dačić.

Duke folur për vazhdimin e sotëm të dialogut të Beogradit e Prishtinës, Dačić ka thënë për "veçernje novosti" se pala serbe nuk pranon asnjë korrjigim të marrëveshjes për AKS-në. "Nëse BE pajtohet për diçka të tillë, e besoj se nuk do të pajtohet, atëherë bie poshtë i tërë dialogu dhe për ne



aty nuk do të ketë më vend", ka theksuar ai. Dačić ka vlerësuar se në një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare dhe në Prishtinë ekziston qëllimi i qartë që serbët

në veri të Kosovës të shpallen faktor destabilizues duke shtuar se ata po luajnë me zjarr.

Ai ka thënë se tash është më lehtë të bisedohet me admini-

stratën në Washington, dhe, sipas tij, ky është shans i mirë për Beogradin, sepse Amerika nuk dëshiron destabilitetin të ri dhe se ajo ka shfaqur interesim për iniciativën serbe për zgjidhjen afatgjatë për Kosovën. Dačić ka theksuar se deri te zgjidhja duhet arritur me kompromis e jo me imponimin e qëndrimit të Serbisë se ajo duhet ta njohë Kosovën. "Do t'i pyesja të gjithë në BE, si është e mundur që vetëm kufijtë e Serbisë u ndryshuan e të tjerët mbeten si kanë qenë – gurë. Së pari e ndanë Kosovën nga Serbia e tash thonë se këtu nuk ka çfarë të flitet më. Ka, si nuk ka. Nëse ka përfunduar rrëfimi, pse po na ftojnë në dialog?", ka pyetur Dačić.

Pranverë me stuhi të fuqishme dhe përmbytje

Temperaturat e ngrohta të pranverës, shumica do i pres me entuziazëm, por ato me vete, në disa pjesë të Evropës dhe në veçanti në Ballkan, do të sjellin stuhi të fuqishme dhe përmbytje. Ky është parashikimi i madh për pranverën nga qendra meteorologjike, AccuWeather. Zona e Gjermanisë deri në Bjellorusi dhe Ukrainë do t'i nënshtrohet kushteve ekstreme atmosferike me stuhi, deri sa reshjet e mëdha të shiut do të rrezikojnë me përmbytje të mëdha, gadi-shullin e Ballkanit. Në perëndim të Evropës pritet një pranverë e thatë e nxehtë, madje me nxehtësi mbi mesatare. Stuhi dhe erëra të forta nuk do të jenë dukuri të jashtëzakonshme në muajt e pranverës, në zonën e Gjermanisë dhe Polonisë, dhe nuk përjashtohen as stuhi shkatërruese me rrufe, thekson meteorologu i AccuWeather, Tyler Roys. "Që në pranverën e hershme, priten stuhi të fuqishme në Gjermani, të cilat mund të shkaktojnë kaos në trafik. Rreziku më i madh nga stuhitë është nga fundi i muajit prill dhe fillimi i muajit maj. Müncheni dhe Berlina në Gjermani, Kievi në Ukrainë dhe Minsku në Bjellorusi do të jenë më të rrezikuara nga stuhitë me rufe", thekson AccuWeather duke shtuar se këto zona përveç se nga stuhitë, do të jenë të rrezikuara edhe nga përmbytjet, e mund të paraqiten edhe tornado. Deri sa stuhitë shkatërruese do të krijojnë probleme serioze në veri, zona e Alpeve deri në Ballkan do të jenë të rrezikuara nga përmbytjet. "Në pjesën më të madhe të dimrit, në Ballkan janë shënuar reshje të shiut dhe borës nën mesatare. Nga fundi i dimrit priten stuhi dhe sasi të mëdha të reshjeve të shiut, të cilat do të vazhdojnë në muajt e pranverës", tha Reppert. Rrezikun nga përmbytjet mund ta shtoj edhe shkrirja e borës në zonat malore. Periudhat me reshje të mëdha të shiut mund të zgjasin në këto zona edhe me ditë të tëra, parashikon AccuWeather. Reshje të borës mund të ketë në zonat malore, deri në fund të muajit mars. Përveç rrezikut nga përmbytjet, ekziston rreziku edhe nga shkarjet e dheut, por kryesisht në zona malore.

Duke folur në telefon me presidentin rus, Vladimir Putin, kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez, Emmanuel Macron, kërkuar ndihmë për zbatimin e rezolutës së OKB-së

Forcat qeveritare të Sirisë kanë vazhduar sulmet ajrore në enklavën e Gutas Lindore, e cila kontrollohet nga rebelët, pavarësisht një rezolute për armëpushim që ka miratuar Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara të shtunën. Qindra njerëz kanë vdekur në një javë bombardime në enklavën që ndodhet pranë kryeqytetit Damask. Sulmet e fundit përfshijnë edhe një ofensivë tokësore. Duke folur në telefon me presidentin rus, Vladimir Putin, kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez, Emmanuel Macron, kërkuar ndihmë për zbatimin e rezolutës së OKB-së. Me këtë rezolutë është rënë dakord që të lejohen dërgesat e ndihmave dhe evakuimet mjekësore. Guta Lindore është zona e fundit e madhe që kontrollohet nga rebelët sirianë. Rusia, që nga fillimi i luftës në Siri në vitin 2011, i ka ofruar mbështetje politike dhe ushtarake qeverisë së presidentit Bashar al-Assad.

"NËSE FËMIJËT NUK VDESIN NGA SULMET, DO TË VDESIN NGA URIA"

Regjimi i Bashar al-Asadit dhe Rusia po kryejnë sulme intensive ajrore dhe tokësore ndaj popullatës së Gutës Lindore afër Damaskut në Siri duke mos njohur të drejtën e jetës kurse civilët shpresën e fundit për të mbijetuar e shohin duke u fshehur në strehimoret nëntokësore. Cjatatë javës së fundit vazhdojnë sulmet e pandërprera intensive nga toka dhe ajri ndaj rajonit të Gutës Lindore e cila ndodhet në lindje të

REGJIMI I ASADIT VAZHDON SULMET NË GUTËN LINDORE

NËSE NUK VDESIN NGA SULMET, DO VDESIN NGA URIA

Damaskut dhe nën kontrollin e opozitarëve. Civilët të cilët gjatë javës së fundit u bllokuan në rrënoja si pasojë e sulmeve të ashpra të regjimit, Rusisë dhe të grupeve të huaja terroriste ndaj vendbanimeve civile, u detyruan të fshihen në strehimoret nëntokësore. Strehimoret nëntokësore ku jetojnë civilët nuk kanë asnjë kusht për ushqim dhe për banim. Për t'u mbrojtur nga sulmet ajrore dhe tokësore më shumë civilë duhet të zbrisin në këto strehimore ndërsa në anën tjetër vazhdojnë punimet për hapjen e tunelëve. Banorët e Gutës Lindore, të cilëve u është marrë e drejta për të jetuar, kanë mbetur të bllokuar në strehimoret ku kanë hyrë për t'u mbrojtur nga vdekja dhe bombardimet e dhunshme. Nëna Um Muhammed e cila është fshehur në strehimore nëntokësore së bashku me fëmijët e saj, për Anadolu Agency tregoi momentet e vështira të cilat po i përjetojnë. "Fëmijët nga Guta Lindore po sulmohen me avionë gjatë 7 viteve. Ata nuk kanë nevojë që të



kryejnë qaq sulme. Tashmë për disa ditë të gjithë do të vdesin nga uria. Asnjë furrë buke nuk punon. Nëse fëmijët nuk vdesin nga sulmet do të vdesin nga uria", tha nëna nga Guta Lindore, Um Muhammed. Duke thënë se kanë hyrë në strehimore nëntokësore për t'u mbrojtur nga sulmet intensive të regjimit dhe të Rusisë, Um Muhammed thotë se "Strehimoret nëntokësore janë të mbushura me fëmijë dhe gra. Në këtë strehimore ndodhen më shumë se 150 gra dhe më shumë se 200 fëmijë. Strehimoret në Gutën Lindore nuk janë të pajisura. Strehim-

orja nuk është e fortë, kur ndërtesat rrënohen edhe strehimoret rrënohen". Duke i bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që ka mbetur i heshtur ndaj sulmeve dhe incidenteve të cilave po u nënshtrohen, Um Muhammed thotë se "Guta Lindore nuk po humb gjak. Guta Lindore po u dhuron gjak atyre që nuk kanë. As avionët, raketat e bombat fuçi të regjimit e as të Rusisë nuk mund të na frikësojnë. Me lejen e Allahut, po mbrohemi nga Allahu, nuk ankohe mi". Ajo po ashtu thotë se organizatat e ndihmave humanitare nuk po i përmbushin detyrat e

tyre. "Tanimë nuk kemi besim tek askush, këtë fjali e kam dëgjuar nga shumë gra. Organizatat e ndihmave humanitare po punojnë për dëlirë. Askush nuk arrin tek ne".

"KU JANË SHTETET ARABE, PSE JANË TË HESHTURA?"

Gade Um Bessam, një nënë tjetër thotë se janë detyruar që të zbrisin në strehimore nëntokësore së bashku me fëmijët e saj me qëllim të mbrojtjes nga sulmet. "Kemi mbetur të bllokuar në strehimore në Gutën Lindore. Po ballafaqohemi me çdo lloj të sulmit dhe të rrënojës. Çdo gjë që mund t'u bie ndërmend po ndodh këtu. Nuk ka energji elektrike dhe dritë. Jetojmë në frikë", thotë Bessam. Duke nënvizuar se po bombardohen me armë të ndaluara, Um Bessam thotë se "Që nga mëngjesi e deri më tani kanë hedhur 200 raketa. Fëmijët kërkojnë ushqim. Për 7 ditë jemi këtu, nuk kemi gjë për të ngrënë. Ku janë shtetet e botës, i thërras ata! Ku janë shtetet arabe, pse janë të heshtura?".

Rrethimi në Gaza u ka marrë jetën 1000 mijë palestinezëve

Për shkak të rrethimit të Izraelit në Gaza për më shumë se 10 vite rreth 1.000 palestinezë kanë humbur jetën. Koordinator i Komitetit të Organizatave Bamirëse në Palestinë, Ahmed el-Kerd në një konferencë për media të titulluar "Viktimat e Rrethimit të Gazës" tha se "Rreth 1.000 persona e kanë humbur jetën për shkak të rrethimit". Kerd bën të ditur se 450 prej tyre kanë humbur jetën për shkak të shembjes së sektorit të shëndetësisë, mungesës së barnave, pajisjeve mjekësore si dhe moslejimit që të dilet jashtë Gazës për trajtim.

Ai bëri të ditur se numri i personave që kanë humbur jetën për këto shkaqe në vitin 2017 është 57. Kerd thotë se 100 persona kanë humbur jetën për shkak të metodave si përdorimi i qirit, sobës dhe metodave të ngjashme si alterna-



tivë për energjinë elektrike pas bombardimit të burimit të vetëm të kësaj energjie në Gaza nga Izraeli. "Pa energji elektrike njerëzit u detyruan të përdorin qirin dhe të djegin dru. Për këtë arsye

shpërtheu një numër i madh zjarresh dhe shumë persona humbën jetën", thotë ai. Kerd njofton se numri i personave të cilët kanë humbur jetën gjatë punës së peshkimit dhe blegtorisë nën kushtet

Protestuesit po ashtu mbajtën pankarta me mbishkrime "Ku është e drejta ime e energjisë elektrike?", "Ku është e drejta ime për jetë të ndershme".

e imponuara nga rrethimi, ka arritur në 350 persona. "Shpëtoni Gazën nga këto kushte. Edhe sa viktima duhen për të vepruar", thotë ai. Duke thënë se Gaza është burg më i madh në botë, Kerd potencon se duhet të gjendet një zgjidhje për ndërprerjet e energjisë elektrike të cilat shkojnë deri në 20 orë. Në anën tjetër një grup i palestinezëve të cilët u mbledhën në sheshin 'Saraya', realizuan një ceremoni simbolike të varrimit për viktimat e rrethimit.

Protestuesit po ashtu mbajtën pankarta me mbishkrime "Ku është e drejta ime e energjisë elektrike?", "Ku është e drejta ime për jetë të ndershme". Izraeli pas daljes me sukses nga zgjidhjet e vitit 2006, filloi të zbatojë rrethimin ndaj Gazës. Përkundër reagimeve ndërkombëtare ky rrethim vazhdon pandërprerë.

OSMANI FLET PAS
FITORES SË VËSHITRË
NDAJ AKADEMIJA
PANDEVIT



Këto pikë na çojnë drejt titullit

Shkup, 26 shkurt - Lideri aktual i tabelës, Shkëndija e Tetovës, në përballjen me Akademia Pandevin, u mundua shumë për të ardhur deri tek fitorja pas humbi dy penallti. Golin e vlefshëm tre pikë, e shënoi Ferhan Hasani, me çka "kuqezinjtë" nga Tetova, diferencën e pikëve me Vardarin e ngritën në 11 pikë. Trajneri i skuadrës tetovare Qatip Osmani pas përfundimit të ndeshjes ka vlerësuar karakterin e futbollistëve të tij dhe thekson se me këto fitore fitohet titulli. "Fitorja për lojtarët e mi është një sukses, këto pika çojnë drejt titullit. Ne kemi treguar një karakter në kushte të vështira për lojë, në një fushë me dëborë dhe dy penallti të porealizuara. Më besoni, nuk do të relaksohemi, kemi 11-të pikë përpara Vardarit, por asgjë nuk është bërë ende. Shumë pikë janë në lojë dhe ne nuk duhet të mendojmë se ne jemi tashmë kampionë", deklaroi trajneri i Shkëndijës.

PËR SHKAK TË RESHURAVE TË MËDHA TË BORËS QË E KAPLUAN VENDIN TONË

FFM SHTYN JAVËN E 22-të DHE NDRYSHON KALENDARIN

E gjithë kjo ishte e qartë se do të ndodhë pasi xhiroja e 21, e cila në program ishte të dielën dhe nuk u kompletua, u zhvillua në kushte jashtëzakonisht të rënda. Derisa, edhe përkundër kësaj, në dyshim është edhe java e 22 e cila është e paraparë të luhet vikendin e ardhshëm, duke marrë parasysh se të reshurat e bora vazhdon të bie në vendin tonë

Shkup, 26 shkurt - Të mërkurën ishte paraparë të zhvillohet java e 22 në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë, mirëpo gjatë ditës së djeshme Komisioni i Garave ka vendosur që të njëjtin ta shtyjë për vikendin e ardhshëm, pra më 3 dhe 4 mars. Arsyeja që Komisioni i Garave u detyra ta bëjë këtë, kanë qenë të reshurat e mëdha të borës që e kapluan vendin tonë. E gjithë kjo ishte e qartë se do të ndodhë



Xhiro e 22 - 04 mars (e diel)
Xhiro e 19 - (Sileks - Skopje),
07 mars (e mërkurë)

Xhiro e 23 - 11 mars (e diel)
Xhiro e 24 - 17 mars (shtunë)
Xhiro e 25 - 29 mars (e enjte)
Xhiro e 26 - 01 prill (e diel)
Xhiro e 21 - (Sileksi - Pelisteri),
04 prill (e mërkurë)

Xhiro e 27 - 08 prill (e diel)
Xhiro e 28 - 15 prill (e diel)
Xhiro e 29 - 18 prill (e mërkurë)
Xhiro e 30 - 22 prill (e diel)
Xhiro e 31 - 25 prill (e mërkurë)
Xhiro e 32 - 29 prill (e diel)
Xhiro e 33 - 02 maj (e mërkurë)
Xhiro e 34 - 06 maj (e diel)
Xhiro e 35 - 13 maj (e diel)
Xhiro e 36 - 20 maj (e diel)

pasi xhiroja e 21, e cila në program ishte të dielën dhe nuk u kompletua, u zhvillua në kushte jashtëzakonisht të rënda. Derisa, edhe përkundër kësaj, në dyshim është edhe java e 22, duke marrë parasysh se të reshurat e bora vazhdon të bie në vendin tonë. Andaj varësisht kushteve klimatike, gjatë ditëve në vazhdim do të inspektohen fushat edhe tek skuadrat e Ligës së dytë, të cilët sezonin pranveror e fillojnë të shtunën. Në anën tjetër nga Komisioni i Garave njoftuan se së sh-

pejti do të përcaktohen terminet ndeshjet e anuluar ndërmjet Sileksit dhe Pelisterit, ndërsa skuadra nga Kratova ndeshjen e anuluar të javës së 19-të kundër Skopjes, është planifikuar ta zhvillojnë më 7 mars. Ndërkohë, përveç kësaj, Për shkak të ndeshjeve të përfaqësuese së Maqedonisë U21 dhe në kërkesë të seleksionuesit Blagoja Milevski, java e 24 e Ligës së Parë të Maqedonisë, në vend të dielës, do të zhvillohet gjatë ditës së shtunë, më 17 mars.

Mediat greke i thurin elozhe Kaçes

Ishte ndeshja e katërt me fanellën e skuadrës së tij të re dhe në momentin e daljes nga fusha, i gjithë stadiumi ngrihet në këmbë për të. Ergys Kaçe është bërë menjëherë një prej lojtarëve më të rëndësishëm të Panatinaikosit. Skuadra e shqiptarit fitoi 2-0 ndaj Lamias në ndeshjen e fundit, por tifozët në shkallët e stadiumit vlerësuan me brohoritje dhe duartrokitje shqiptarin në momentin e

daljes nga fusha, ndërsa edhe vetë mediat greke e cilësuan si më të mirin në fushën e lojës. Për shqiptarin ishte një merkato e trazuar, pasi dy ditë para mbylljes së dritares së transferimeve, kishte akord në Qipro, por ultrasit e asaj skuadre penguan transferimin. Në ditën e fundit, Panatinaikos dhe PAOK gjetën një akord për huazimin deri në fund të sezonit. Në fund të sfidës, shqiptari ka marrë

vlerësimin si më i miri nga mediat greke. "Ka treguar formën e tij më të mirë. Ishte më i miri në fushën e lojës, sidomos në pjesën e parë, por edhe në të dytën tregohet në lartësinë e duhur. Ka fituar rolin e liderit në mesfushën e Panatinaikosit dhe me të drejtë merr duartrokitjet e të gjithë të pranishmëve në stadium kur zëvendësohet", ishte vlerësimi nga "panathinaikoskosmos".



NUHIU LAVDËRON LOJTARËT PËR ANGAZHIMIN NDAJ POBEDËS

Lojtarët treguan karakter, barazuan me meritë



Shkup, 26 shkurt - Plotë gjashtë gola u shënuan të dielën në Manastir ku u përballën Pobeda dhe Shkupi. Të dyja këto skuadra nga një herë e panë veten në avantazh dhe në fund morën nga 1 pikë. Ky barazim ka kënaqur më shumë bardhekaltërit, të cilët pesë minuta para fundit ishin në negativë, por falë golit të turkut Emre Khan, i shpëtuan disfatës. Trajneri Ardian Nuhiu pas ndeshjes uroi lojtarët e

të dyja skuadrave për "luftën" e pakompromis në fushën e vështirë i cili ishte i mbuluar me borë. "Unë dua ti përgëzoj aktorët e ndeshjes. Të luash në këtë nivel në një fushë kaq të vështirë, është për lëvdatë. Ne luajtëm mirë në pjesën e parë, në 0-2 nuk realizuam penalltinë, e cila do të ndryshonte rrjedhën e ndeshjes. Pas kartonit të kuq të cilin e mori Adem, ishte shumë më e vështirë, sepse nde-

shja mori një drejtim tjetër. Pobjeda përmbysi rezultatin, por lojtarët e mi treguan karakter. Nuk u dorëzuam deri në fund dhe me meritë barazuan. Urime për 'luftën' dhe angazhimin e tyre në këto kushte të vështira", deklaroi Nuhiu. Ndërkohë, me këtë barazim Shkupi ndan pozitën e pestë me Rabotniçkin, me të cilin pikërisht në fundjavë do të matin forcat në stadiumin "Boris Trajkovski".

EKLESTON ZBULON PRAPASKENAT

Pak kohë më parë, Bernie Ekleston pat hedhur idenë e një kampionati alternativ të Formula 1, por në rast se Ferrari vendos të largohet nga ky sport pas kërcënimeve të presidentit Sergio Markionne, ky kampionat mund të bëhet realitet



FERRARI PO KRIJON NJË "FORMULA 1 ALTERNATIVE"

Ish-pronari i garave të automobilizimit ka rëfyer se drejtuesit e "kokëkuqes" janë duke kryer bisedime sekrete me pronarë të makinave të tjera për ta bërë realitet këtë gjë. "Markionne ka pasur disa bisedime kohët e fundit. Më vjen keq për 'Li-

berty Media' që nuk i merr seriozisht fjalët e presidentit të Ferrarit për largimin nga Formula 1. Nuk besoj se Markionne flet kot, pasi e njoh mirë. Nëse vendos të bëjë diçka, vijon në rrugën e tij", tha Ekleston. Më tej, ish-pronari shton: "Është e thjeshtë,

Formula 1 është Ferrari dhe Ferrari është Formula 1. Njerëzve nuk u intereson të shohin makina të zakonshme në këtë sport, të shohin një garë pa Ferrarin në startin e saj. Nëse makina italiane vendos të largohet dhe tërheq pas vetes makina të tje-

ra, për Formula 1 është fundi. Faktori ekonomik është i rëndësishëm në këtë sport, ndaj Liberty Media' duhet të gjejë një gjuhë të përbashkët me makinat kryesore të këtij sporti, në të kundërt rrezikon të dështojë", tha Ekleston. Kontrata aktuale e Ferrarit

me Formula 1 skadon në vitin 2021 dhe deri atëherë shpresohet që palët të gjejë një zgjidhje. Liberty Media kërkon të ulë kostot e këtij sporti, por po has në pengesën e skuadrave kryesore, kryesisht të Ferrarit.

Publicitet

LAJMËRIM

Shoqëria aksionare në pronësi të shtetit për kryerje të veprimtarisë dhënie të shërbimeve të navigacionit të futuriave M-NAV SHA Shkup do të shkollojë 12 kandidatë për marrje të lejes për kontrollor të futuriave.

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË POSAÇME PËR PRANIM TË KANDIDATËVE PËR SHKOLLIM

- Të jetë i/e moshës së rritur
- Të mos jetë më i/e vjetër se 25 vjet
- Të ketë të mbaruar së paku shkallën e IV të përgatitjes profesionale
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze që i përgjigjet së paku nivelit B2 (certificate B2)

DOKUMENTET TË CILAT KANDIDATI DUHET TË PARASHTRON

- Fletëparaqitje (fletëparaqitja mund të merret në ueb faqen e M-NAV, www.mnavigation.mk)
- Certifikatë të lindjes – jo më të vjetër se 3 (tre) muaj
- Certifikatë të shtetësisë – jo më të vjetër se 3 (tre) muaj
- Dëshmi për arsim të mbaruar së paku shkalla IV e përgatitjes profesionale
- Vërtetim nga evidenca e ndëshkimeve të dhënë nga gjykata kompetente – jo më të vjetër se 3 (tre) muaj
- Certifikatë nga evidenca penale e dhënë nga gjykata kompetente – jo më të vjetër se 3 (tre) muaj
- Dokument/dëshmi për njohje të gjuhës angleze që i përgjigjet së paku nivelit B2 të dhënë nga institucion i autorizuar për mësim të gjuhës së huaj.

Dokumentacioni i lartpërmendur duhet të parashtrohet në original ose kopje të vërtetuar në noter.
INFORMACIONET E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURËN PËR PËRZGJEDHJE TË KANDIDATËVE
Procedura për përzgjedhje të kandidatëve do të realizohet në fazë. Secila fazë është selektive, që do të thotë se në secilin fazë të ardhshme do të ftohen kandidatët që kanë përbushur kushtet nga faza paraprake edhe atë:

- Dorëzim në kohë të fletëparaqitjeve me dokumentet e kërkuara.
- Nëse numri i kandidatëve të paraqitur kalon 300, M-NAV SHA Shkup do të realizojë test paraseleksionues me shkrim të gjuhës angleze.
Pas realizimit të testit do të përpilohet listë të maksimum 300 kandidatëve më të suksesshëm.
- Me maksimum 300 kandidatët e suksesshëm të shpallur në listë të M-NAV do të realizohet FEAST testimi për posedim të aftësive, karakteristikave dhe predispozicioneve të përgjithshme dhe specifike, të nevojshme për shkolim për kontrollor të futuriave. (më shumë informata në lidhje me testimin mund të gjenden në ueb faqen www.feast.info).
Kandidatët të cilët më herët kanë dhënë FEAST testin nuk do të testohen sërish, por mund të konkurrojnë me më shumë rezultate të arritura nga testimi.
- Posedim të aftësive shëndetësore – certifikatë të mjekut të klasës 3 në pajtim me Rregullores për kushtet e posaçme, mënyrës dhe procedurës për përcaktim të aftësive shëndetësore të personelit në fluturime dhe personelit tjetër profesional, afatet e vlefshme të certifikatës së mjekut dhe kushtet e posaçme që duhet t'i përbushin institucionet shëndetësore dhe mjeku i autorizuar individual për kryerje të kontrollave mjekësore të personelit të fluturimeve dhe personelit tjetër profesional (Gazeta Zyrtare e RM nr. 49/08, 87/11 dhe 169/13).
Kandidatët të cilët realizojnë në institucionin e autorizuar shëndetësor dhe shpenzimet për realizimin e tyre do të jenë në barrë të M-NAV.
- Nëse pas realizimit të fazave seleksionuese 3 dhe 4 nuk ka kandidatë të mjaftueshëm të suksesshëm (minimum 15), etapa 3 dhe 4 do të realizohet për 30 kandidatët e ardhshëm nga testin paraseleksionues nga faza 2, deri në arrijen e numrit minimal.
- Me kandidatët të cilët në mënyrë të suksesshme i kanë kaluar të gjitha fazat paraprake do të realizohet intervistë nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.
- Lista përfundimtare e kandidatëve do të publikohet në afat prej 5 ditëve nga dita e përfundimit të intervistës, duke konsideruar nga data e mbajtjes së intervistës me kandidatën e fundit.
- Të gjithë kandidatët nga lista përfundimtare janë të obliguar para fillimit të shkolimit të nënshkruajnë Marrëveshje për shkolim me M-NAV SHA Shkup.

VËREJTJE
Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet. Kandidatët për të cilët do të përcaktohet se më herët kanë dhënë FEAST testin ndërsa të njëjtin nuk e paraqesin do të diskualifikohen.

Me kandidatët të cilët në mënyrë të suksesshme do të përfundojnë shkolimin M-NAV SHA Shkup do të lidhë Marrëveshje për punësim.

Dokumentacioni i nevojshëm për përbushje të kushteve në original ose kopje të vërtetuar në noter të parashtrohet (personalisht ose përmes postës me dërgesë rekomanduese) në Arkivin e M-NAV SHA Shkup, rr. Maqedonia nr. 25, kati 7 (Pallati Llazar Pop Trajkov).

Afat për parashkrimin e dokumentacionit të nevojshëm është 15 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të Lajmërimin.

Kushtet e theksuara në Lajmërim, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes.

M-NAV SHA Shkup

REPUBLICA E MAQEDONISË
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike

IO

Në bazë të nenit 131 dhe nenit 135, paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror dhe nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorant të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, Dekani i Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup publikon:

KONKURS
Për zgjedhje në titujt mësimor

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatike dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatikë

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup. Orari i punës do të përcaktohet në pajtim me orarin e orëve.

Pagesa për pozitën 1 lëvizë prej 28.000,00 deri më 44.000,00 denarë.

Për pozitën 1 së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje sipas konkursit në të cilën do të qëndrojë se për cilën pozitë paraqiten, dokument për arsimin e mbaruar përkatës, (diplomat e huaja të jenë të nostrifikuar dhe të plotësuar me ekuivalencë të notave), biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale (nga një kopje të punimeve); Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 131 nga Ligji për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit)

Dokumentet të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuar në noter – fletëparaqitjet të cilat nuk janë të plotësuar nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
Fletëparaqitjet të dorëzohen më së voni 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit në Dekanatin e Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike, rr. Rugjer Boshkoviq 16, Shkup.
Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2005 167/15 dhe 27/2016), dhe miratimi nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë nr. 12-1041/1 prej 29.01.2018, për punësimin e personelit teknik ndihmës në kohë të pacaktuar në bazë të financimit të vjetër, Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin", shpall:

SHPALLJE PUBLIKE
për punësimin e personelit teknik
ndihmës në kohë të pacaktuar

Publikohet Shpallje publike për punësimin e personelit teknik ndihmës në kohë të pacaktuar në bazë të financimit të vjetër si në vijim:

- Mjeshtrë i përgjithshëm me arsim të mesëm të mbaruar, 40 orë pune në javë, punë me ndërrime, paga fillestare 14.885,00 denarë.
- Mirëmbajtës i higjienës - 3 realizues me arsim të mesëm të mbaruar, 40 orë pune në javë, punë me ndërrime, paga fillestare 10.800,00 denarë.

Kandidatët të cilët paraqiten në shpallje duhet i përbushin kushtet e përgjithshme të parapara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet në shpallje

Orari i punës për mjeshtrë të përgjithshëm dhe mirëmbajtës të higjienës është në dy ndërrime dhe atë: Ndërrimi i parë prej ora 6,00 deri ora 14,00, ndërsa ndërrimi i dytë prej orës 12,00 deri në ora 20,00. Puna javore është 40 orë, e sistemuar në 5 ditë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm përparaqitje në shpallje:

- Dëshmi (dëftesa) për arsim fillor-mesëm të mbaruar.
- Certifikata e shtetësisë të R.M

Konkursi zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes në gazetë ditore.

Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të kryhet në afat prej 20 ditë pas mbylljes së shpalljes.

Dokumentet e dorëzuara me vonesë dhe jo të kompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet të dorëzohen me postë të rekomanduar ose në arkivin e Shkollës së mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin", rr. Lihnida nr. 3.,-1000 Shkup, tel. 2037-073

Shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit "Koço Racin"

Taksi Transport Afrodita Taksi TP Abdula Ramadan Etemi Shkup, rr.10 br.57 Inxhikov, Gazi Bab - Shkup me NVTS 7102437 dhe nr.tatimor 5043016501840 me xhirollogari 270071024370178 Halk banka e themeluar nga Abdulla Etemi me 15.02.2016, Shkup, rr 10 nr.57 Inxhikovo Gazi Baba- Shkup si mbartës i firmës te personi Ismail Bektesh nga Shkupi, rr.Vergina 94, Shkup me vend të përhershëm të banimit në Shkup si bartës mbi vete të firmës nga data 27.02.2018

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po + Pr + 2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Janë humbur dëftesat e klasës 5, 6, 7 dhe 8 të SHF "Jane Sandanski" - Shkup të personit Elvie Ibraimi dhe njëkohësisht shpallen të pavlefshme.

GATUSO FLET PËR TË ARDHMEN E TIJ DHE REZULTATET E MILANIT



DUA TË QËNDROJ NË MILANO, NDJEHEM SI NË SHTËPI

Sigurisht, nëse ma propozojnë tani këtë gjë, unë nuk nënshkruaj për çështje besëtytnie. Falënderoj klubin dhe këta drejtues, të cilët më kanë dhënë një mundësi të pabesueshme. Nëse Fassone, Mirabelli, Davide dhe Li nuk besonin tek mua, nuk do të ma jepnin mundësinë për të trajnuar një ekip të tillë. Prioritet është që të qëndroj në Milano, sepse ndihem në shtëpi. Jam krenar që po punoj këtu”, thotë Gattuso

Milani i Gattusos fiton përsëri, edhe në Romë, dhe tani vërtet ëndërron të kapë trenin që e çon në Ligën e Kampionëve. “Ringhio” bind gjithnjë e më shumë dhe dëshiron të vazhdojë përqendrimin në funksion të angazhimeve të ardhshme, në mes të Kupës së Italisë dhe derbit të Milanos. “Në fund të ndeshjes, – tha Gattuso për “Premium Sports”, – i përshëndeta djemtë. U thashë atyre për t’i mbajtur këmbët në tokë. Dallimin nuk është duke e bërë talenti, se Milani ka pasur gjithmonë, por mentaliteti, vullneti dhe mënyra si vuajmë së bashku”, shprehet Gattuso pas përfundimit të ndeshjes me Romën. Sekretet është mbrojtja kuqezi, me tetë ndeshje të pastra (pa pësuar gol) në 12 sfidat e fundit. “Ky është një

faktor i dukshëm. Është e njohur se ekipi kishte cilësi të mëdha, ndaj kemi punuar në kompaktësinë e grupit. Gjithkush duhet të jetë në dispozicion të tjetrit. Unë e kam ndërtuar kështu karrierën dhe dua ta vazhdoj këtë rrugë”, vazhdon Gattuso.

Derbi me Interin do të jetë një tjetër pikë fokale, por para është një “finale” e Kupës së Italisë për të fituar. “Unë nuk jam duke menduar për derbin. Mendimet janë te Lacio. Ne luajmë diçka të rëndësishme kundër një ekipi shumë të fortë. Duhet të rimarrim energjitë dhe ta kemi mendjen atje. Pastaj, do të mendojmë për derbin”. Në fund ai foli edhe për ripërtëritjen e famshme e kontratës. “Sigurisht, nëse ma propozojnë tani këtë gjë, unë nuk

nënshkruaj për çështje besëtytnie. Falënderoj klubin dhe këta drejtues, të cilët më kanë dhënë një mundësi të pabesueshme. Nëse Fassone, Mirabelli, Davide dhe Li nuk besonin tek mua, nuk do të ma jepnin mundësinë për të trajnuar një ekip të tillë. Prioritet është që të qëndroj në Milano, sepse ndihem në shtëpi. Jam krenar që po punoj këtu”, përfundoi Gattuso. Cekim, pas javës së 26, Milani ndan pozitën e gjashtë me Sampdorian me 44 pikë, pozitë kjo e cila mundëson pjesëmarrjen në Liga Evropë, derisa nga pozita e katërt, e cila aktualisht i takon Interit, e ndajnë shtatë pikë. Ndërkohë, të dielën Gattuso me djemtë e tij do të përballen pikërisht me rivalin e saj lokal Inter.

LAJME SHKURT

Isko kërkon largimin nga Reali

Sipas “Daily Express” është edhe Isko në listën e dëshirave të Hoze Murinjos, për merkaton e verës. Fantazisti i Real Madrid, që ka kontratë deri në 2022, me një klauzolë 700 milionë euro, është i pakënaqur me aktivizimin nga ana e trajnerit Zidan dhe është gati të largohet nga madrilenët pavarësisht marrëveshjes që ka. Nga kjo situatë kërkon të përfitojë Manchester Junajted, me trajnerin portugez që dëshiron ta sjellë sa më parë në “Old Trafford”.

Arsenali bën sërish pazar te Lioni

Milani dhe Arsenal përplasën edhe në merkato. Të dyja skuadrat kanë shfaqur interes të madh për të firmosur me yllin e Lionit, Nabil Fekir. 24-vjeçari në këtë sezon të Ligue 1 ka spikatur me francezët dhe kjo ka bërë që të jetë një ndër lojtarët më të kërkuar në Francë. Arsenali është gati të derdhë në arkat e Lionit plot 50 milionë euro, shumë disi e lartë për italianët, çka bën që “Topçinjtë” të jenë më favoritë se skuadra e Gattusos.

Bajerni hedh grepat për Malkom

Bajerni Muni është në konkurrencë me Arsenalin dhe Totenhemin për shërbimet e Malkom, që aktivizohet në radhët e Bordos. Klubi bavarez është në kërkim të pasuesit të Frank Riberi, dhe sulmuesi 21-vjeçar i francezëve është një ndër emrat e përfolur te kampionët e Bundesligës. Siç raportojnë mediat gjermane, mes palëve është gjetur edhe akordi paraprak për në kontratë që zgjat 5 vjet, dhe kanë mbetur për t’u përcaktuar vetëm disa detaje të tjera.

Ylli i Napolit targeti kryesor i Liverpoolit

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp përveç Naby Keita në skuadër e dëshiron edhe një mesfushor të ri gjatë verës. Largimi i Emre Khan ka shtyrë gjermanin të kërkojë edhe një mesfushor, me mesfushorin e Napolit, Zhorginjio si objektivin kryesor. Transferimi i tij nuk do të jetë aspak i lehtë, sepse atë e duan edhe disa skuadra tjera të mëdha të Evropës.

Konfirmohet transferimi i parë i Realit

Real Madrid gjatë verës do të kthejë në skuadër mesfushorin Omar Maskarell. Mesfushori Omar Maskarell gjatë dy viteve të fundit ka luajtur për skuadrën gjermane, A인트라ht Frankfurt, ku është shndërruar në një shtyllë të kësaj skuadre. shkruan AS. Kjo nuk ka kaluar pa u vërejtur nga Real Madrid, nga e cila skuadër kishin kaluar në Gjermani dy vite më parë. Lojtari ka një klauzolë ku lejon kthimin në Madrid për 4 milionë euro, shumë të cilën spanjollët do ta paguajnë. Si pjesë e kësaj marrëveshje, në Frankfurt mund të kalojë mesfushori i Realit, Markos Llorente, që ka pasur shumë pak hapësira këtë sezon



EMRI I KLUBIT MËSOHET TË MARTËN Bolt konfirmon se ka firmosur me një klub



Pavarësisht tetë medaljeve të Arta në Olimpiada dhe dy rekordeve botërore në garat e 100 dhe 200 metrave, Usian Bolt nuk e ka fshehur asnjëherë dëshirën e tij dëshirën për t’u shndërruar në një futbollist profesionist. Shumë shpejt ëndrra e sprinterit xhamajkan pritet të bëhet realitet pasi vetëm disa muaj pas tërheqjes nga garat e atletikës, Bolt ka nënshkruar një kontratë si profesionist me një skuadër futbollit. Usian e ka bërë publike vetë lajmin e bujshëm me një postim në profilin e tij në “Twitter” në të cilin xhamajkani bën me dije se emrin e skuadrës të gjitha

fansat e tij do ta mësojnë vetëm ditën e martë. Një tifoz i thekur i Manchester Junajtedit madje ka qenë i ftuar edhe në disa raste në “Old Trafford” për të ndjekur sfidat e “Djave të Kuq”, për Bolt u përfol se ka pasur kontakte me Borussia dhe Dortmundit madje gjatë muajit mars pritet të bënte një provë me verdhezinjtë. Në muajin e kaluar ndërkohë xhamajkani u stërvit me një skuadër që luan në Afrikën e Jugut. Tashmë pritet me kureshtje për t’u mësuar se nga do të nisë rrugëtimin e tij në futbollin rekordmen i garave të shpejtësi-së 100 dhe 200 metra.

LAJMETË MIRË PËR KAMPIN ZIKALTËR

IKARDI KTHEHET NDAJ MILANIT

Një lajm i lumtur për Interin, i gatshëm për të gjetur përsëri princin e tij bombardues. Me të në fushë, zikaltrit kanë shënuar 37 gola në 22 ndeshje (1.68 gola për ndeshje), ndërsa në katër ndeshje pa kontributin e tij, janë realizuar vetëm pesë gola (1.25 gola për ndeshje)

Tri pikët e fituara me vështirësi kundër Beneventos e kanë lejuar Interin që të paktën të rimarrë vendin e katërt, falë ndihmës së kushërinjve të Milanit, të cilët kanë shkaktuar një goditje të rëndë për Romën në skenën e "Olimpico". Edhe në këtë rrethanë, zikaltrit kanë qenë të detyruar të bëjnë pa kapitenin Mauro Icardi, i cili ende është duke luftuar me një zgjatim të "adductor"-it, çka e mban atë jashtë veprimit prej një muaji (para-

qitja e tij e fundit daton në 28 janar, kundër SPAL). Edhe kundër Beneventos u kursye nga Spaleti, që nuk preferoi ta rrezikonte atë për të shmangur pasojat e mundshme për derbin e rëndësishëm kundër Milanit, të planifikuar për të dielën, më 4 mars, një sfidë vendimtare për sezonin e Interit. Për këtë lojë, Icardi duhet të jetë më në fund në dispozicion, siç pranohej nga trajneri Interit. "Ai ka një problem të 'adductor'-it. U kthye për t'u ba-

shkuar me grupin paraprakisht, por kishte ende një ankesë. E lamë ende pushim, por për derbin do të jetë atje", tha Spaleti. Një lajm i lumtur për Interin, i gatshëm për të gjetur përsëri princin e tij bombardues. Me të në fushë, zikaltrit kanë shënuar 37 gola në 22 ndeshje (1.68 gola për ndeshje), ndërsa në katër ndeshje pa kontributin e tij, janë realizuar vetëm pesë gola (1.25 gola për ndeshje). Por, për të skalitur idenë se sa i rëndësishëm

është për Interin sulmuesi argjentinas, mjafton një fakt tjetër: prej atyre 37 golave të shënuar, kur ai ishte në fushë, 18 mbajnë firmën e tij, me një përqindje, që në fakt arrijnë kuotën 48 për qind, pra gati gjysma. Shifra unike që shpjegojnë se si Interi nuk mund të injorojë Icardin, ende duke ndjekur vulën e 100 golave në Seria A (89 me fanellën e Interit, 10 me atë të Sampdorias). Derbi mund të jetë rasti i duhur për të festuar këtë objektivist prestigjioz.



Juventus-Atalanta, më 13 ose 14 mars

Një borë e madhe e ka detyruar Juventusin dhe Atalantën që të kthehen në dhomat e zhveshjeve (dhe rrjedhimisht në shtëpi). Rreziku për sigurinë e lojtarëve në fushë është shumë i lartë, në një tapet të zbardhur tërësisht nga dëborë e rënë në Torino. Ironikisht, gjysmë ore pas fillimit hipotetik të ndeshjes (18:30), dëborë ndaloi të binte. Megjithatë, tashmë ishte tepër vonë. Në këtë pikë, ajo që ndikon më shumë te tifozët është data e luajtjes kësaj sfide, e rëndësishme për luftën e "Scudetto". Liga e Seria A është sqaruar me këtë deklaratë: "Liga do të rregullojë në ditët e ardhshme datën e ndeshjes Juventus-Atalanta, e cila do të luhet të martën, 13 mars, ose të mërkurën, 14 mars". Dy ditë në lojë, pra, edhe pse sidomos në rastin e Juventusit, do të thotë të bëjë zgjedhje të rëndësishme. Ekziston edhe një hipotezë e katërt, që Liga ta shtyjë vendimin për më 8 mars, pas ndeshjes së bardhezinjve kundër Totenhemit. Nëse ata nuk arrijnë në çerekfinale të Çampionisit, atëherë do të përpiqet që ndeshja e ditës së diel, e shtyrë për shkak të dëborës, të luhet në prill.



Asgjë serioze, Neymar një javë jashtë fushës

Ylli i Paris Sen Zhermenit, Neymar, u shtrëngua fort në pjesën e dytë kundër Marsej, të dielën, pasi iu rrotullua kyçi i këmbës, edhe pse mjekët kanë përjashtuar dëme serioze. Braziliiani e kishte kokën në duart e tij dhe dukej se ishte në lot, pasi u çua jashtë fushës, duke ngjallur frikën se ai mund të përballlet me një qëndrim të gjatë nënjanë skuadrës. 26-vjeçari ishte duke u përpjekur të luante një top në minutën e 76-të dhe, pas një përplasjeje me mesfushorin e Marsej, Bouna Sarr, shfaqti probleme në kyçin e këmbës dhe u rrëzua në tokë me dhimbje. PSZH-ja ishte 3-0 në kohën e lëndimit dhe e fitoi ndeshjen me të njëjtin rezultat, pavarësisht se duhej ta luante



pjesën tjetër të klasikes franceze me 10 lojtarë, pasi i kishte bërë të gjitha zëvendësimet. Udhëheqësit e Ligue 1 do të përballen me Real Madridin në ndeshjen e dytë të 1/8 finale të Ligës së Kampionëve

me 6 mars, duke qenë në disavantazhin 3-1 të ndeshjes së parë. Raportet e para nga Spitali Amerikan, ku Neymar u trajtua në shokërinë e shokëve të ekipit, Maksvell dhe Markuinjos, ishin pozitive

për yllin. Neymar u "pastrua" nga vuajtja e një frakture, apo shtrëmbërimi serioz në kyçin e këmbës dhe shëndeti i tij do të monitorohet në 48 orët e ardhshme. Të paktën ai pritet të humbasë një javë për PSZH-në, me prova të mëtejshme që pritet të përcaktojnë ashpërsinë e lëndimit të tij. "Është normale të shqetësohemi për Neymarin dhe të shohim se si është gjendja e tij. Dhe, nëse ka një dëmtim, është normale të shqetësohemi për këtë, - tha Kavani për "Canal +". - Por, jemi gjithmonë pozitivë dhe shpresoj se gjithçka po shkon mirë, që ai të mund të shërohet sa më shpejt dhe të jetë me ne në ndeshjet e ardhshme", deklaroi sulmuesi nga Uruguai.



Konte kërkon VAR-in në Angli

Trajneri i Çellsit, Antonio Conte është i pakënaqur me humbjen 2-1 të skuadrës së tij ndaj Mançester Junajtedit për shkak të golit të mohuar të Alvaro Moratas. Shpresat e Çellsit për të përfunduar në vend të dytë janë venitur disi pas kësaj disfatë megjithëse Uillian kaloi në avantazh Blutë, por Lukaku dhe Lingard përmbysën gjithçka për vendasit. Morata u duk sikur arriti të shënonte golin e barazimit në fund të takimit, megjithëse ishte brenda loje, goli i tij është anuluar për

pozicion jashtë loje. Dhe Conte ishte i pakënaqur pas ndeshjes. "Mendoj se barazimi ishte një rezultat i drejtë për këtë ndeshje. Por fakti është se kemi humbur. Duhet të tregohem i sigurtë, nuk e pashë situatën, por nëse po më thonë se Morata nuk ishte pozicion jashtë loje, atëherë mendoj se VAR është shumë i rëndësishëm, sidomos në Angli. Duhet të tregohemi më cinikë në disa momente. Mançesteri është një ekip i madh, gjithsesi ne duhet të jemi të pakënaqur, pasi sot mendoj se mund të kishim bërë më mirë. E dimë që po luftojmë për një vend në 'Champions League' dhe do të jetë e vështirë të gjejmë një arritmë mes katër më të mirëve", deklaroi Conte.

DASHI 21. mars - 20. prill
Dite e kënaqshme kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Do jeni shumë besnikë ndaj partnerit tuaj dhe nuk do tundoheni aspak nga disa persona që do i uoshin. Beqaret nuk duhet ta humbin kohën kot me aventura kalimtare, por të bëjnë edhe pak durim për dashurinë madhe. Në planin material do e konsolidoni situatën dhe do jeni me të qete.

DEMI 21. prill - 21. maj
Nëse keni pasur mosmarrëveshje me partnerin tuaj duhet t'i zgjidhni sa më parë sot. Sa më shumë t'i lini ato pas dore, aq më shumë situata do ndërlikohet. Beqareve do iu shkojnë gjërat me se miri. Te gjitha dëshirat që kanë pasur për jetën sentimentale do iu plotësohen. Në planin financiar nuk do keni as problemin me të vogël. Mund të bëni pa frikë ndonjë shpenzim me tepër.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Merkuri do iu nxite të tregoheni me të disponueshem ndaj partnerit dhe do keni durim ta dëgjoni atë gjithë kohës. Marrëdhënia mes jush do fillojë të përmirësohet ndjeshëm. Beqaret nuk duhet të nxitohen për asgjë sepse mund të përballen me zhgënjime. Sektori i financave do vazhdojë të mbrohet nga yjet. Nëse keni menduar për ndonjë investim, është momenti i duhur.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Do e mbani gjithë kohës të zgjuar sot zjarrin e pasionit dhe emocionet në çift do jene shumë të forta. Shfrytëzojeni çdo minute dhe çdo sekonde. Beqaret do kenë disa takime interesante dhe do arrijnë të bëjnë për vete një person interesant. Në planin financiar duhet të shmangni transaksionet e mëdha sepse situata nuk do jete fort e përshtatshme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Venusi do jete planeti me i favorshëm për jetën tuaj në çift sot. Do kuptoheni me se miri me partnerin tuaj dhe nuk do i mbani aspak mëri njeri-tjetrit. Beqaret ka shumë gjase ta gjejnë shpirtin e tyre binjak dhe do ndihen të plotësuar. Do ia vlejë gjithë pritja jua e gjate. Financat do jene shumë të paqëndrueshme. Shmangni sa të mundni shpenzimet e tejskajshme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Do jeni shumë të shpërqendruar gjatë kësaj dite dhe nuk do i kushtoni vëmendjen e duhur jetës suaj në çift. Nëse me të vërtetë keni ndonjë çështje të rëndësishme për të zgjidhur flisni me partnerin dhe sqarojta situatën. Beqaret nuk do kenë asnjë ndryshim në jetën sentimentale. Në planin financiar duhet të tregoheni të matur dhe me largpamës.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Edhe nëse i keni kaluar problemet në çift gjatë kësaj dite, duhet të vazhdoni të tregoheni vigjilente. Mos kërkoni që të rikthehet menjëherë pasioni i dikurshëm. Beqaret do kenë një takim shumë të rëndësishëm i cili shumë shpejt mund t'ua ndryshojë rrjedhën e jetës. Financat do jene shumë me të mira se disa kohe më parë. Do jeni të qete në këtë sektor.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Nën ndikimin e Merkurit do ruani një komunikim të mire me partnerin tuaj sot dhe nuk do ketë asnjë rrezik për debata e konflikte. Beqaret nga ana tjetër do ndihen mire edhe ashtu si janë, megjithatë nuk do iu thonë jo disa ftesave joshëse që do iu bëhen. Asnjëherë nuk i dihet çfarë ndodh. Në planin financiar nuk ehte koha për të bere çmenduri. Situata do jete delikate.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Klima në jetën tuaj në çift do jete shumë ngrohte gjatë kësaj dite. Çdo gjë do e bëni në bashkëpunim me personin që keni në krah dhe kjo do iu beje të mendoni me tepër për një të ardhme bashke. Beqaret nuk duhet të thurin shumë ëndrra sepse realiteti mund t'i zhgënjëjë. Neptuni do iu ndihmojë të vendosni pak rregull në planin financiar.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Edhe pse keni shumë kohe që jeni në një lidhje, ka gjasa që të keni një konkurrence shumë të forte sot. Përkujdesuni me tepër për partnerin sepse po e late pas dore dikush tjetër do ua rrëmbejë përgjithmonë. Beqaret do kenë mundësi me shumice për të pasur njohje të reja, prandaj duhet t'i shfrytëzojnë sa të mundin ato. Financat fatmirësisht nuk do jene problematike.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
etojeni çdo moment si t'iu vije sot pa menduar fare për ditët në vijim. Duhet me patjetër ta përmirësoni marrëdhënien në çift dhe të riktheni entuziazmin e dikurshëm. Beqaret nuk do jene shumë të qarte se çfarë duan sot dhe për këtë arsye me mire të mos dalin neper takime. Financat do jene delikate dhe nuk do e dini as vete sesi do ia dilni. Kërkoni ndihme!

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Gjerat do shkojnë edhe me mire sesa e kishit menduar sot në jetën tuaj në çift dhe emocionet do jene me të vërtetë të forta. Gjithë dita do jete në harmoni të plote. Beqaret do mbeten serish vetëm edhe pse nuk do mungojnë takimet. Asnjëri nuk do iu duket aq i përshtatshëm sa për të filluar një lidhje. Situata financiare do jete përgjithësisht e qëndrueshme.



KOHA	ASTRONOMI POLAK, NIKOLAUS	K	PASTRON	ERBIUMI	PUNIMI I ARËS PËR MBJELLJE METRI				
DEBAT, DISKUTIM I GJALLË									RRËSHIRË BIMËSH AFRIKANE QË LESHON TYM ME ERE TË MIRE
T					STOLI VESHI PËR FEMRA				
ISH BOKSIERI AMERIKAN, NORTON				KËNGËTARE TURKE					
TIRANA			MAKARONA TË HOLLA					PËREMËR PRONOR	
ZBUKURIMI I FLOKEVE			POETI YNË, MIFTARI					ARRATA	
A								JODI	
QË U TAKON ARIANEVE								CEREMONI	
KOHA	FËMIJË (ANG.)				LITRI			NJËSI KINEZE E GJATËSISË	
REOMIRI					METRI			AZOTI	
PUE E FORTË ALKOOLIKE				VENDLINDJA E ARTISTIT NË FOTO (LEZHE)					

ZGJIDHJET: APASH, MARK, ASHTU, TKURR, KOPRI, RË, SH, RUT, K, LAVRA, POLEMIKAT, TIPAR, VATHËT, KEN, HADISE, TR, FIDHE, IM, ONDULIMI, J, ARIANE, IKRA, KID, L, JIN, RUM, MANATI.

Sudoku

shumë i lehtë
mesatar

1	2	8	9	6	1	2	8	9	6
5	3	6	8	5	3	6	8		
5	3	7	5	3	7				
2	5	2	5						
6	7	3	6	7	3				
7	4	1	2	7	4	1	2		
8	1	2	6	5	8	1	2	6	5

Shumë i lehtë: 698172543, 132584976, 754396281, 985213764, 327649158, 416758392, 573461829, 841927635, 269835417. Mesatar: 516472938, 382659714, 497813625, 271538496, 849726153, 653194287, 164285379, 928367541, 735941862.

DUA LIPA viziton xhaminë në Abu Dhabi

Këngëtarja Dua Lipa ka vizituar një nga xhamitë në Abu Dhabi, me ç'rast ka bërë edhe disa fotografi e mbuluar me shami. Ajo ka publikuar disa fotografi në rrjetet sociale, ndërsa thotë e ka parë xhaminë më të bukur në Abu Dhabi. Fotografitë i ka bërë Pixie Levinson. "Para koncertit në Abu Dhabi vizitua xhaminë më të bukur. Isha e nderuar, faleminderit", ka shkruar ajo në Facebook.



Prezantohet Nokia 8110 4G që kushton 80 euro

HMD Global vazhdon të ringjallë telefonat legjendar të Nokias, dhe këtë herë erdhi modeli Nokia 8110. Telefoni Nokia 8110 ka fituar statusin e tij të kultit në Matrix (të gjithë kujtojmë skenën ku Neo përdor Nokia 8110 dhe kërkon "Armë - Shumë Armë"). Nokia 8110 4G përmban një dizajn të lakueshëm të njohur dhe madje vjen në opsionin e ngjyrës së verdhë banane, si dhe variantet më serioze tradicionale të zezë. Gjithashtu, në pjesën e poshtme ka një slider-cover, që siguron ndjeshmëri të prekshme kur bëhen thirrjet. Telefoni është i bazuar në të njëjtë platformë sikurse edhe Nokia 3310 4G, përkatësisht përdor YunOS. Pajisja ka Google Search, Maps dhe mbështetjen për Assistant. Me këtë model nuk mund të hyni në Matrix, por Nokia 8110 4G do t'ju mundësojë qasjen në Facebook dhe Twitter. Nokia premton mbështetje edhe për disa aplikacione, të cialt janë në zhvillim. Telefoni ka procesor Snapdragon 205, ekran 2.4 inç me rezolucion QHD. Bateria ka 1500mAh dhe zgjat mbi 9 orë për thirrjet VoLTE, si dhe mbi 48 orë gjatë dëgjimit të muzikës. Ekziston edhe versioni me një dhe dy SIM kartela. Nokia 8110 4G do të dalë në treg në muajin maj me çmim prej 80 eurosh.



Në Danimarkë studentët nuk paguajnë... paguhen



Interesimi i nxënësve që dilnin nga bankat e gjimnazit për universitetin ka qenë vazhdimisht në rënie në Danimarkë. Të rinjtë u adresoheshin kryesisht shkollave dhe kurseve profesionale, duke shmangur koston e lartë dhe vitet e gjata të studimeve. Por, gjithçka ka ndryshuar. Të ndjekësh studimet e larta në Danimarkë jo vetëm që është pa taksa e kosto të tjera, por edhe shpërblehet. Qeveria daneze paguan me 1 mijë dollarë në muaj çdo student, që jeton e studion larg vendlindjes së tij. Megjithatë, kjo ka shkaktuar jo pak debat në vend. Pyetja që diskutohet është: a duhet të paguajnë taksapaguesit apo vetë studenti arsimimin e tij të lartë? Ata që e mbështesin këtë nismë të qeverisë janë të shumtë, por po kaq të shumtë janë edhe kundërshtarët. Danimarka, Skocia, Norvegjia dhe Finlanda janë të vetmet vende në Europë ku nuk ka tarifë shkolimi për studentët.

Të sodisësh punonjëset e seksit, gjobitesh



Nga muaji prill, kushdo që do të vizitojë lagjen e "dritave të kuqe" në Amsterdam, bën mirë që të përditësohet me rregullat për të shmangur gjobitjen. Autoritetet holandeze njoftuan se nga muaji prill, kushdo që viziton këtë lagje si turist, duhet t'u kthejë shpinën vajzave thujse të zhveshura që qëndrojnë nëpër vitrinat e shtëpive publike. Kushdo që nuk e respekton këtë rregull, do të gjobitet herën e parë me 170 euro, ndërsa në rast se shkelja përsëritet, gjoba dyfishohet. Përgjegjësia për të respektuar këtë rregull bie edhe mbi agjencitë turistike që sjellin ture në këtë qytet të Holandës. Autoritetet vendore argumentojnë këtë rregull me faktin se shumë punonjëse të industrisë së seksit në këtë lagje të Amsterdamit janë ankuar se shqetësohen gjatë punës së tyre.


KALENDARI HISTORIK 27 SHKURT

1557 - Vendoset Ambasada e parë ruse në Londër.
1670 - Hebrenjtë dëbohen nga Austria me urdhrin e Leopold I
1803 - Zjarr i madh në Bombai të Indisë.
1861 - Masakra e Varshavës: Rusët shtypin me dhunë turmën e protestuesve kundër Rusisë.
1933 - Shkatërrohet nga zjarri ndërtesa e Parlamentit të Gjermanisë.
1938 - Britania dhe Franca njohin qeverinë e Frankos në Spanjë.
1945 - Libani shpall pavarësinë.
1976 - Takimi i fundit mes Mao Ce Tungut dhe Richard Nixon
1980 - Izraeli dhe Egjipti këmbëjnë ambasadorët.
2003 - Ish udhëheqësja e serbëve të Bosnjës, Biljana Plavshiq dënohet nga Tribunali i Hagës me 11 vjet burg.

16.4 milionë amerikanë mendojnë se çokollata me qumësht vjen nga lopët bojëkafe, 78% nuk e dinë se "pickles" janë trançuj turshi dhe 72% nuk e dinë se buka vjen nga gruri. Po ashtu, një e pesta e amerikanëve nuk e dinë që djathi bëhet nga qumështi.



NASA ka filluar "udhëtimin hapësinor" më 1 tetor 1958, ndërsa deri tani ka dërguar 2200 kafshë në hapësirë.



Vendi që konsumon më shumë vezë për njeri është Meksika, me një mesatare prej 350 vezë në vit për person, e ndjekur nga Japonia me 330 dhe Kina me 320.



SHPRESA DHE NJOMZA

- Shpresa çkemi?
- Mirë Njomza çka bone ti?
- Mirë, ku e paske burrin mi?
- Te kopshti...
- Nuk po e shoh...
- Duhet të gërmosh pak...

THËNIA E DITËS



Ti i vetëm mjafton.
Nuk ke asgjë për t'i provuar,
askujt.
(Maya Angelou)